



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 203 Akti

Nr. 393 Vendimi  
Tiranë, më 3.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, më datë 1.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Gerd Hoxha**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.11.2018, zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Xhensila Pine.

4. Bazuar në vendimin e Komisionit nr. 6, datë 21.1.2019, relatorja e çështjes, znj. Pine, ka dhënë dorëheqjen nga ky subjekt më 30.1.2019. Trupi gjykues i ngritur me vendimin nr. 7, datë 30.1.2019 të Komisionit, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës për dorëheqje, me vendimin e datës 4.2.2019, ka vendosur pranimin e saj. Menjëherë kjo çështje i ka kaluar anëtarit zëvendësues, znj. Alma Faskaj.

5. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 6.2.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues zoti Olsi Komici, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Gerd Hoxha.

6. Me vendimin nr. 17, datë 9.3.2020 të Komisionit u vendos rishpërndarja e çështjeve të vitit 2018 dhe 2019 të komisioneres Alma Faskaj (si relatores), për shkak të mungesës së saj pa afat, për arsye objektive. Me shortin e datës 10.04.2020, relator i subjektit Gerd Hoxha u zgjodh komisionere Genta Tafa (Bungo).

7. Më 29.4.2020, relatorja ka dhënë dorëheqjen për shkak të konfliktit të interesit të mundshëm/në dukje, sepse kishte marrë pjesë si anëtare e trupit gjykues në procesin e rivlerësimit të znj. P.P., motra e subjektit Gerd Hoxha. Trupi gjykues i ngritur me short, miratuar me vendimin nr. 25, datë 30.4.2020 të Komisionit, për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje, ka vendosur më 12.5.2020 mospranimin e kësaj kërkesë.

Në këto kushte, nga relatorja çështjes u mor në administrim dokumentacionin dhe filloi procedura e rivlerësimit.

8. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

9. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të

krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

**10.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**11.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**12.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**13.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**14.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha.

**15.** Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2018.

<sup>2</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*, datë 1.3.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2019.

**16.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**17.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 27.04.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**18.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 5.5.2021, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Me e-mail-in e datës 19.5.2021 subjekti ka kërkuar shtyrjen e afatit me një ditë për të paraqitur parashtrimet e tij, kërkesë e cila është miratuar Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 6.5.2021, ndërsa më 21.5.2021 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**19.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**20.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 26.5.2021.

**21.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 01.06.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

**22.** Subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**23.** Z. Gerd Hoxha ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**23.1** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

---

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 25.5.2021.

#### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

**24.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**24.1.** Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**24.2.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ; (ë) denoncimet e publikut; (f) gjetjet dhe opinionin e paqitura me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

##### A. VLERËSIMI I PASURISË

**25.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

**26. Apartament<sup>6</sup>** me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*+\*-\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në adresën: rruga “S.F”, kati \*, ap. \*\*, Tiranë, në bashkëpronësi me ish- bashkëshorten znj. E.Ll, në shumën 6.500.000 lekë. Çmimi i blerjes është i ulët për shkak të marrëdhënies së posaçme mes znj. E.Ll dhe znj. A.Ç (Ll) e z. A.Ç. Pjesa prej 50% e Znj. E.Ll është përfituar prej saj me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse, për pasojë, vlera e apartamentit është më e ulët së çmimi i tregut. Pas rivlerësimit të bërë vlera e sendit është 23.750.000 lekë, pjesa takuese 50%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** shuma prej 6.500.000 lekësh është siguruar nga kredia bankare 5.000.000 lekë, e marrë nga subjekti në BKT, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”; diferenca prej 1.500.000 lekësh është siguruar nga kursimet personale ndër vite.

### **Hetimi<sup>7</sup>/ Analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**26.1** Në datën 10.02.2011, me kontratë premtim shitjeje me nr. \*\*\* kol., datë 10.2.2011, subjekti, së bashku me ish-bashkëshorten e tij, kanë blerë nga znj. A dhe z. A.Ç<sup>8</sup>, apartamentin nr. \*\*, me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup>, (\*+\*+A), ndodhur në rrugën “S.F”, Tiranë.

Çmimi i blerjes është caktuar 6.500.000 lekë. Në nenin 3 të kontratës përcaktohet se çmimi është më i ulët se vlera e tregut, për shkak të marrëdhënieve të ngushta gjinore midis palëve.

Mënyra e pagesës, bazuar në kontratë, do të bëhet me dy këste:

- kësti i parë në shumën 1.500.000 lekë është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë në shumën 5.000.000 lekë do të kalojë në favor të palës shitëse në momentin e lëvrimit të kredisë nga banka BKT.

Apartamenti është rivlerësuar nga znj. A. Ll në datën 14.12.2011 në shumën 23,750,000 lekë, duke u paguar dhe detyrimet në shumën 202,500 lekë.

Në datën 10.10.2012 është lidhur kontrata e shitjes nr. \*\*\* kol., datë 10.10.2012.

Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Tiranë, apartamenti është i regjistruar në emër të subjektit dhe ish-bashkëshortes së tij me nr. pasurie \*\*+\*-\*\*, zona kadastrale \*\*\*.

Nga hetimi ka rezultuar se ky apartament është blerë nga motra e ish-bashkëshortes së subjektit në shumën 3,500,000 lekë me kontratën nr. \*\*\*, datë 24.0.2002 nga shoqëria “A” sh.p.k., ku administrator dhe ortak i vetëm ka qenë z. A.Ç.

<sup>6</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë premtim shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.2.2011; (ii) kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.10.2012; (iii) certifikatë pronësie nr. \*\*\*\*, për apartamentin me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup>; (iv) kartela e pasurisë së paluajtshme; (v) ekstrakt historik i QKB-së për shoqërinë “H” sh.p.k.; (vi) certifikatë martese e shtetasve A.Ç dhe A. Ç; (vii) vërtetim nga BKT me nr. extra prot., datë 20.1.2017; (viii) kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.6.2011; (ix) kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.6.2011.

<sup>7</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; kthim përgjigjeje ZVRPP Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar OSHEE; kthim përgjigjeje OSHEE-ja nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar UKT-së; kthim përgjigjeje UKT-ja nr. K-\*\*\* prot., datë 8.3.2019; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar bankave; kthim përgjigjeje BKT-ja nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019.

<sup>8</sup> Motra dhe bashkëshorti i ish-bashkëshortes së subjektit.

**26.2** Në deklaratën “Vetting”<sup>9</sup> subjekti ka deklaruar se pjesa takuese prej 50% e bashkëshortes së tij është përfituar prej saj me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse, për pasojë, vlera e apartamentit është më e ulët se çmimi i tregut.

**26.3** Si burim për blerjen e pjesës së tij takuese të këtij apartamenti subjekti ka deklaruar: (i) kredi nga BKT-ja; (ii) kursime nga paga.

### **26.3.1 Në lidhje me kredinë**

Në datën 9.6.2011 subjekti ka lidhur kontratë kredie bankare nr. \*\*\* në vlerën 5,000,000 lekë me afat 25 vjet. Nga përmbajtja e kontratë së kredisë rezulton se kjo kredi është marrë me kushte lehtësuese dhe i është dhënë subjektit për nevoja strehimi.

Komisioni hetoi mbi plotësimin e kriterëve për përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese. Sipas VKM-së nr. 600, datë datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, kriteret për përfitim janë parashikuar në pikën 5 dhe 6 të saj.

Në momentin e lidhjes së kësaj kontrate kredie, subjekti: (i) ka qenë me statusin civil “beqar”<sup>10</sup>, bazuar në të dhënat e gjendjes civile; (ii) ai nuk ka pasur pasuri të paluajshme në pronësi të tij<sup>11</sup>; (iii) si dhe nuk ka pasur gjendje likuiditet mbi shumën e kredisë<sup>12</sup> sipas nenit 6, germa “ç” e VKM-së.

Në aneksin element specifik të kredisë përcaktohet se: “Shuma e kredisë do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar A.Ç dhe A.Ç me transfertë bankare nëpërmjet BKT”.

Për garantimin e kësaj kredie është lidhur kontratë hipotekimi nr.\*\*\*, datë 9.6.2011 nëpërmjet së cilës hipotekohet apartamenti i mësipërm.

Nga nxjerrja e llogarisë në lekë të subjektit, rezulton se në datën 15.6.2011 është transferuar shuma 4,900,000 lekë në llogari të A.Ç.

### **26.3.2 Në lidhje me shumën 1 500 000 lekë, të deklaruar nga subjekti si kursime personale ndër vite**

i. Në DVP/2003 subjekti deklaroi gjendje *cash* në shumën 2,500,000 lekë me burim nga Shkolla e Magjistraturës dhe sektori privat.

Në lidhje me shumën 2,500,000 lekë subjekti në deklaratën e datës 20.1.2015 pranë ILDKPKI-së ka sqaruar se: “Shuma prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë e deklaruar nga ai, në deklarin fillstar të vitit 2003, disponohej tërësisht nga ai në formë *cash*, në banesën e tij dhe është krijuar nga kursimet e tij nga: paga si student i Shkollës së Magjistraturës (përfshirë edhe vitin III të stazhit si gjyqtar) e kursyer e gjitha, plus të ardhurat e kursyera nga punësimi gjatë 5 viteve të shkollës së lartë, në sektorin privat (bare, restorante, lojëra fati, llotari, këmbim valutor, etj...). Gjatë kësaj kohe të gjitha shpenzimet e tij përballoheshin nga prindërit, me të cilët banonte.”

ii. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura neto të fituara nga puna në sektorin privat dhe vetëpunësim (bare, restorante, lojra fati, bingo, këmbim valutor, laborant dentar, etj.) për periudhën 1995 - 2000, në shumën 1,500,000 lekë.

<sup>9</sup> Deklarim, i cili përputhet dhe me deklarin e subjektit në DVP/2011.

<sup>10</sup> Subjekti ka lidhur martesë më 9.7.2012.

<sup>11</sup> Provuar me shkresën kthim përgjigje ZVRPP-së Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019

<sup>12</sup> Bazuar në analizën e kryer nga Komisioni, mbështetur mbi të dhënat bankare dhe deklarimet periodike të pasurisë.

Në lidhje me këto të ardhura i është kërkuar subjektit dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të tyre. Në përgjigje të pyetësorit të datës 6.8.2020 subjekti sqaron se:

*“Shuma prej 1 500 000 lekësh është e fituar nga ai gjatë viteve 1995-2000 si më poshtë:*

- i. Menaxher shitjesh dhe shpërndarje në pikat e shitjes në Tiranë dhe Institut-Kamëz gjatë periudhës tetor 1995 – tetor 1997, në shoqëritë “S.ID” sh.p.k. dhe “Xh” sh.p.k. **Paga mujore 20 000 lekë.***
- ii. Gjatë periudhës janar 1998 – dhjetor 1998 ka punuar si shitës në shoqërinë “F – B”, sh.p.k, me administrator Z.V.Ç dhe pronarë Z.V.Ç dhe z.A.D, **me pagë mujore 12 000 lekë në muaj plus të ardhura nga bakshishet, jo më pak se 1 000 lekë në ditë, që për nga vetë natyra e punës, nuk përfshiheshin në pagë.***
- iii. Kamarier në “Bar-Kafe T”, nga muaji janar 1999 deri në muajin maj të vitit 2000. Ky lokal ka ekzistuar që nga viti 1994 deri në vitin 2004. Paguesa ka qenë **12 000 lekë në muaj** ndërsa, bakshishet kanë qenë përgjithësisht jo më pak se **1 000 lekë në ditë, të cilat për nga vetë natyra e tyre, por edhe sipas një rregulloreje të lokalit nuk përfshiheshin në pagë dhe i takonin kamarierit.**”*

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka depozituar:

**a.** Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.07.2018, lëshuar nga znj.G.Xh<sup>13</sup>.

Në këtë deklaratë kjo shtetase deklaron se: “ ...Duke filluar nga viti 1994 familja ka patur në pronësi shoqëritë private “S. ID” sh.p.k dhe “Xh” sh.p.k...Gjatë periudhës tetor 1995-tetor 1997 Gerd Hoxha ka qenë i punësuar në këto shoqëri i pasiguruar...me pagë 20,000 lekë/muaj”

**b.** Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 15.6.2020 të Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë, sipas së cilës rezulton se: “Për subjektin juridik “Xh” sh.p.k. për periudhën 1.10.1995-30.10.1997 nuk administrojnë listë pagesa deri tani. Në dosjen \*\*\* listëpagesat fillojnë në janar të vitit 1998.”

**c.** Deklaratë noteriale nr.\*\*\*, datë 5.7.2018, lëshuar nga z.P.A.

Në këtë deklaratë ky shtetas deklaron se: “ ...Nga muaji mars 1996 - dhjetor 1998 ka qenë punonjës në bingon “F. B”, të ndodhur në blvd. “Zogu I”, godina e gazetës “Z.P”, Tiranë. Në periudhën janar 1998 - dhjetor 1998 z. Gerd Hoxha ka qenë punonjës në bingon “F. B”. Paga mujore e tyre ka qenë 12, 000 lekë/muaj, ndërsa të ardhurat nga bakshishet jo më pak se 1 000 lekë në ditë.”

**d.** Deklaratë noteriale nr.\*\*\*, dt.14.08.2020 lëshuar nga z.V.Ç.

Në këtë deklaratë ky shtetas deklaron se: “ ...Nga viti 1998 e në vazhdim ka qenë administrator dhe ortak i shoqërisë “F.B”. Kjo shoqëri kishte si pjesë të aktivitetit të saj edhe “B.T” me seli në blvd. “Zogu I”, te godina e gazetës “Z.P”, Tiranë. Në këtë bingo ka qenë punonjës z. Gerd Hoxha... për periudhën janar 1998 - dhjetor 1998 me pagë 12, 000 lekë/muaj neto, ndërsa të ardhurat nga bakshishet kanë qenë jo më pak se 1 000 lekë në ditë....për z. Gerd Hoxha nuk janë paguar sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore për të ardhurat fakt për të cilin z. H nuk ka qenë në dijeni.”

**e.** Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2020 të Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë, sipas së cilës rezulton se: “ Nga verifikimi i bërë në DAQ emri i subjektit nuk figuron në listëpagesë.

---

<sup>13</sup> Subjekti deklaron se është bashkëshortja e të ndjerit z.D. Xh dhe nëna e shtetasit F.Xh (prej më shumë se 10 vitesh rezident në SHBA), të cilët kanë qenë pronarë dhe administratorë të shoqërive të mësipërme.



f. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, dtë 26.6.2018, lëshuar nga z. H.H.

Në këtë deklaratë ky shtetas deklaron se: "...Ka patur në pronësi bar -kafe "T" në Tiranë në buzë të Lanës përballë me lulishten "1 M". Ky lokal është hapur në vitin 1994 dhe ka ekzistuar deri në vitin 2004. Në këtë lokal nga muaji janar 1999- në maj të vitit 2000 ka punuar si kamarier i pasiguruar në ISSH, z. Gerd Hoxha. Pagesa mujore 12, 000 lekë/muaj në pagë nuk përfshiheshin pjesë e bakshisheve 1 000 lekë në ditë."

Në përgjigje të pyetësorit të datës 5.2.2021 në lidhje me shumën 2,500,000 lekë subjekti sqaron se kjo shumë përbëhet nga:

- i. *Një shumë në total prej rreth 1,226,196.00 lekë përfaqëson (i) të ardhurat e tij neto nga pagesat si student i Shkollës së Magjistraturës (tetor 2000 - tetor 2002); dhe (ii) të ardhurat neto si gjyqtar, për periudhën nëntor 2002 – dhjetor 2003...*
- ii. *Shuma e mbetur e kursimit prej 1,273,804 lekë është kursyer nga të ardhurat e tij të përfituara nga puna me kohë të pjesshme dhe shërbimet e ofruara, gjatë kohës që ka qenë student, për një periudhë 5-vjeçare nga viti 1995 deri në vitin 2000 sipas përshkrimit si më poshtë:*
  - *Tetor 1995 – tetor 1997: marrëdhënie shërbimi me kohë të pjesshme si manaxher dhe distributor i shitjeve për shoqëritë "Xh" sh.p.k. dhe "S. ID" sh.p.k. të cilat në atë kohë zotëroheshin nga i njëjti pronar. Në total shpërblimi për shërbimet me kohë të pjesshme ka qenë në vlerën **480,000 lekë**.*
  - *Janar 1998 – dhjetor 1998, për një periudhë 1-vjeçare ka punuar me kohë të pjesshme pranë shoqërisë "F-B" sh.a., duke shërbyer në pozicionin e shitësit. Të ardhurat e në këtë periudhë për shërbimin me kohë të pjesshme kanë qenë në shumën **504,000**, ku përfshihen paga në vlerën prej 144,000 lekë dhe shpërblime në formë bakshishi në vlerën prej 360,000 lekë.*
  - *Janar 1999 – maj 2000, për një periudhë rreth 17-mujore ka shërbyer pranë subjektit "Bar Kafe T" me kohë të pjesshme, në pozicionin e kamarierit. Gjatë kësaj periudhe 17-mujore të ardhurat kanë qenë në vlerën **672,000 lekë**, ku përfshihen paga në vlerën prej 192,000 lekë dhe shpërblime në formë bakshishi në vlerën prej 480,000 lekë.*

*Në lidhje me të ardhurat e mësipërme, në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm, pagesa për të gjitha tatimet e aplikueshme, si dhe kontributet (në rastet kur ato janë të aplikueshme për t'u paguar), janë përgjegjësi e punëdhënësit, dhe sa më sipër ka qenë përgjegjësia e punëdhënëseve të tij për të kryer çdo pagesë dhe për t'i dokumentuar ato...*

*Me qëllim për të qenë sa më bashkëpunues me Komisionin, i është drejtuar ISSH-së, Dega Tiranë, e cila konfirmon me shkresën \*\*\*, datë 12.2.2021, që nuk është në gjendje të identifikojë pagesa kontributesh për këtë periudhë, pasi listat për vitet 1994 deri më 2002 nuk gjenden më në këtë institucion dhe kërkesa i është përcjellë tashmë Drejtorisë së Arkivës në Lundër. Gjithashtu ISSH-ja konfirmon që për pagesat e tjera si honorare, shpërblime, etj. në atë kohë nuk paguheshin sigurime shoqërore.*

*Drejtorja e Arkivit Qëndror më datë 11.02.2021, ka lëshuar shkresat \*\*\*, datë 11.02.2011, sipas së cilave Drejtorja e Arkivit Qëndror Tiranë konfirmon se:*

- *Për subjektin "Xh", nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni;*
- *Për subjektin "F – B", është kontrolluar dosja me nr. \*\*\*, me NIPT J\*\*\*F dhe emri i tij nuk figuron; dhe*
- *Për subjektin "Bar - Kafe T", u kontrollua dosja me nr. \*\*\*, me NIPT K\*\*\*\*O dhe rezulton që nuk gjenden listëpagesa e kontributeve shoqërore.*

*Pavarësisht përpjekjeve të tij në vazhdimësi dhe në mirëbesim, për të gjetur dhe siguruar sa më shumë informacion dhe dokumenta provuese për një pjesë të të ardhurave të deklaruara pjesa më e madhe e të cilave janë të pamunduara të identifikohen apo gjenden,*

*për shkak se situata faktike ka ndodhur 22-26 vite më parë, sepse personat që mund të dispononin këtë dokumentacion kanë ndërruar jetë, dhe/ose për faktin se institucionet nuk i disponojnë më këto dokumente, aktualisht gjendet në kushtet e parashikuara në paragrafin nr. 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë në përputhje me paragrafin nr. 5 nenit 32 të ligjit 84/2016, duke patur parasysh që këto interesa privatë të tij që datojnë 22-26 vite më parë, faktikisht janë deklaruar prej tij në mënyrë të rregullt dhe transparente menjëherë që në deklarinimin e parë periodik në ILDKPKI, pothuaj 18 vite më parë...*

Subjekti ka depozituar:

i. Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.02.2021 të Drejtorisë Rajonale Tiranë ISSH.

Në këtë shkresë sqarohet se:

- a. mbështetur në VKM-në nr. 452, datë 16.09.1993, VKM-në nr. 42, datë 23.1.1995, VKM-në nr. 73, datë 30.1.1998 pika IV, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: *“Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.”*
- b. honoraret, pagesat për kontrata e shërbimit apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore.
- ii. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021 të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, ku vërtetohet se për subjektin “Xh” sh.p.k., për periudhën tetor 1995-tetor 1997, me administrator D. Xh, nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni.
- iii. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, ku vërtetohet se është kontrolluar dosja nr. \*\*\*, me NIPT J\*\*\*F dhe rezulton se emri i subjektit nuk figuron.
- iv. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, për subjektin “Bar- Kafe T”, për periudhën janar 1999 - maj 2000, u kontrollua dosja nr. \*\*\*, me NIPT K\*\*\* O dhe rezulton që për periudhën e kërkuar nuk ka listëpagesa.

**26.3.3** Në përfundim të hetimit, në lidhje me shumën 1,500,000 lekë të fituara nga puna në sektorin privat dhe vetëpunësim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar: (i) pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me këtë shumë; (ii) përfitimin e kësaj shume nga ana e tij për shkak të punësimit.

**26.3.4** Në parashtrimet e tij subjekti u ka qëndruar shpjegimeve dhe provave të paraqitura më parë pranë Komisionit gjatë hetimit administrativ. Ai ka sqaruar më tej se i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në lidhje me pagesën e të gjitha tatimeve në burim / të ardhura për shërbimet e kryera nga ana e tij në shoqëritë ku ka punuar gjatë viteve 1995-2000. Në përgjigjen me shkrim, DRT-ja e ka njoftuar që për shkak të periudhës kohore, është në pamundësi të vërtetojë pagesën e tatimit në burim, për periudhat e kërkuara, edhe për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informativ.

Subjekti ka pretenduar se ai ka shteruar të gjitha dhe çdo mundësi dhe rrugë ligjore për të siguruar sa më shumë informacion dhe dokumente provuese për shumën e përfituar nga puna e tij në vitet 1995-2000 duke:

- i. siguruar deklarata noteriale përkatëse të pronarëve apo ish-pronarëve të shoqërive tregtare, apo të personave të lidhur që kanë patur dijani, kur këta ish-pronarë përfitues kanë ndërruar jetë, për të provuar marrëdhënien dhe të ardhurat e siguruarat prej tij;
- ii. pasur parasysh që konform ligjit të zbatueshëm në periudhën kohore 1995-1999, regjistrimet dhe pagesat përkatëse të kontributeve shoqërore/shëndetësore (nëse do të aplikoheshin) dhe tatimit në burim, kur dhe ashtu siç mund të aplikohen, kanë qenë përgjegjësi e subjekteve tregtare, ai ka kërkuar zyrtarisht nga institucionet përkatëse (Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë) dokumentacion në lidhje me çdo pagesë sigurimesh shoqërore/shëndetësore dhe tatime në burim / të ardhura dhe këto institucione kanë dështuar të gjejnë dhe sigurojnë dëshmi të pagesave të kryera nga subjektet tregtare, kryesisht për shkak të periudhës mjaft të hershme kohore dhe mungesës së sistemeve të informatizimit në atë kohë.

Pavarësisht përpjekjeve të tij maksimale për të siguruar informacion dhe dokumentacion provues shtesë nga organet kompetente të ngarkuara nga ligji, pavarësisht se detyrimi për pagesa dhe evidencat në lidhje me to, bie mbi subjektet tregtare, dhe duke patur parasysh që tashmë këto organe, nuk janë në gjendje, kryesisht për shkak të kohës mjaft të largët dhe mungesës së informatizimit, të identifikojnë këto dokumente, dhe për sa kohë sa më sipër është tërësisht jashtë kontrollit të tij, ai gjendet qartësisht në kushtet e parashikuara në paragrafin nr. 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka kërkuar që Komisioni të përdorë si provë deklarimet e tij në deklaratat e pasurisë ndër vite në përputhje me paragrafin 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh që këto interesa privatë, që datojnë 22-26 vite më parë, janë deklaruar prej tij në mënyrë të rregullt dhe transparente menjëherë që në momentin e deklarimit të parë periodik në ILDKPKI.

Subjekti ka depozituar:

- i. kërkesë, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, datë 18.5.2021;
- ii. kthim përgjigjeje DRT-ja Tiranë nr. \*\*\*\* prot., datë 20.5.2021 ku sqarohet se:

*Nga të dhënat që disponohet në regjistrat e llogarive të tatimeve të tjera, si dhe nga verifikimet e kryera në bazë të dhënave banka llogari të tjera, e administruar nga DRT-ja Tiranë e mbajtur jashtë sistemit informatik elektronik deri në periudhën 31.12.2014,*

- për periudhën tetor 1995 - tetor 1997 për shoqërinë “Xh” me NIPT J\*\*\*\*F;
- për periudhën janar 1998 - dhjetor 1998 për shoqërinë “F-B” me NIPT J\*\*\*F;
- për periudhën janar 1999 - maj 2000 për shoqërinë “Bar Kafe T”,

*kanë pamundësi të vërtetojnë pagesën e tatimit në burim për periudhat e sipërcituara për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik për këtë periudhë.*

**26.3.5** Komisioni mori në shqyrtim dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, si dhe të gjitha provat e paraqitura nga ai gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe pas kalimit të barrës së provës. Nga kjo analizë rezultoi se:

- i. subjekti ka provuar me anë të deklaratave të punëdhënësit faktin se ai ka punuar me kohë të pjesshme gjatë kohës që ka qenë student;
- ii. punonjësit me kohë të pjesshme nuk i nënshtroheshin pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, provuar kjo me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021 të Drejtorisë Rajonale Tiranë, të ISSH-së ku sqarohet se:
  - a. Mbështetur në VKM-në nr. 452 datë 16.9.1993, VKM-në nr. 42, datë 23.1.1995, VKM-së nr. 73, datë 30.1.1998, pika IV “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703,

datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

*“Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.”*

b. honoraret, pagesat për kontrata e shërbimit apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

Pagesa për këtë punë i nënshtrohej vetëm detyrimit tatimor që mbahej në burim të të ardhurave<sup>14</sup>. Agjent tatimor për këtë lloj tatimi, ligji ka përcaktuar punëdhënësin dhe në asnjë rast punëmarrësin. Në këto kushte, subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor të kontrollonte pagesën e tatimit.

iii. nga ana e organeve shtetërore deklarohet se ato nuk kanë të dhëna në lidhje me shoqëritë ku ka punuar subjekti i rivlerësimit për pagesën e tatimit në burim, si dhe të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

iv. subjekti, gjatë periudhës 1995-2000, ka qenë student dhe nuk ka qenë subjekt rivlerësimi, rrethanë e cila duhet të merret në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të njohjes së shumës 1,500,000 lekë, si e ardhur nga puna e tij në sektorin privat.

v. Pas fillimit të detyrës, në deklarimin e kryer për herë të parë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar këtë shumë në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin burim si në deklaratën “Vetting”. Komisioni mban në vëmendje pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin e kërkuar, duke iu drejtuar zyrtarisht institucioneve përkatëse. Në të gjitha rastet përgjigjja e institucioneve ka qenë mungesë e të dhënave për shkak të kalimit të një kohe tepër të gjatë, pothuajse përpara 20-23 vjetësh, si dhe mungesës së një sistemi informatik në atë periudhë. Subjekti është në pamundësi reale për të provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura, duke qenë se nuk ka qenë detyrim i tij për ta paguar, si dhe nuk ka qenë në detyrë për t’u treguar i kujdesshëm në kontrollin dhe ruajtjen e informacionit. Komisioni vlerëson se mungesa e të dhënave në institucionet që kanë detyrimin ligjor në përpunimin dhe ruajtjen e këtyre të dhënave, nuk mund të penalizojë subjektin pas 20 vjetësh, duke pasur në konsideratë këtu pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare shumën e deklaruar nga subjekti, si të përfituar nga puna e tij me kohë të pjesshëm, në sektorin privat, për periudhën 1995-2000, prej 1,500,000 lekë (duke konsideruar si kursim shumën 1,273,804 lekë), sepse:

- i. kjo shumë është deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2003<sup>15</sup>;
- ii. kjo shumë është krijuar nga puna e subjektit gjatë kohës që ka qenë student;
- iii. kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit;

<sup>14</sup> Ligj nr.7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”.

<sup>15</sup> Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016.

- iv. ISSH-ja nuk disponon asnjë lloj dokumentacioni për subjektin “Xh” sh.p.k<sup>16</sup>, nuk disponon listpagesa për subjektin “Bar-Kafe T”<sup>17</sup>, ndërkohë në dosjen nr. \*\*\*, që i përket “F.B”<sup>18</sup> emri i subjektit nuk rezulton;
- v. bazuar në shkresën e ISSH-së Tiranë, honoraret, pagesat për kontrata e shërbimit, apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, nuk përfshihen në pagën mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore dhe shëndetësore;
- vi. nga ana e DRT-së Tiranë deklarohet pamundësia për të vërtetuar pagesën e tatimit në burim për shkak të mospasjes së të dhënave të plota dhe mungesës së një sistemi unik informatik;
- vii. subjekti nuk ka patur detyrim ligjor të verifikojë pagesën e tatimit në atë periudhë për aq kohë sa ishte student dhe jo në detyrë;
- viii. pagesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfutur nga puna me kohë të pjesshme është detyrim ligjor i punëdhënësit.
- ix. subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin, duke ezauruar në mënyrë shteruese me punëdhënësit dhe institucionet shtetërore, ai ka qenë këmbëngulës në kërkimet e tij, duke i provuar këto përpjekje, në përputhje me nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Mosparaqitja e dokumenteve justifikuese për pagesën e detyrimeve tatimore nga subjekti rezulton se është bërë për shkaqe të arsyeshme;
- x. edhe pse nuk ka një dokument shkresor në kohë reale që të vërtetojë këto të ardhura, rezulton se ato janë deklaruar rregullisht në DPV-në e vitit 2003, kur subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 2,500,000 lekë me burim të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura të realizuara në sektorin privat gjatë periudhës 1995-2000 dhe DPV-në e vitit 2004, ku ka deklaruar kursime *cash* në shumën 1,500,000 lekë me burim nga paga nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga puna në sektorin privat nga viti 1995, akte të cilat, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 përbëjnë provë shkresore për efekt të procesit të rivlerësimit.
- xi. Komisioni mban në vëmendje edhe faktin se shuma prej 1,273,804 lekë e pretenduar si e fituar gjatë periudhës 1995-2000 është një shumë brenda kufijve të arsyes, duke u përpjesëtuar në muaj rezulton afërsisht 20 000 lekë në muaj, që është e pranueshme si pagë për atë periudhë, për atë lloj pune.

#### 26.4 Analiza financiare për blerjen e apartamentit

Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e subjektit për të paguar shumën 1,500,000 lekë në datën 10.2.2011, pasi shuma tjetër prej 5,000,000 lekësh është shlyer nëpërmjet kredisë bankare.

	Pagesë e këstit të parë <i>cash</i> datë 10.2.2011
<b>PASURITË</b>	<b>0.00</b>
Apartament me sip. 125 m <sup>2</sup> (në bashkëpronësi me Gerd Hoxha) 50%, kontratë premtim shitje nr. ***, datë 10.2.2011, pala blerëse Gerd Hoxha dhe E.LI)	1,500,000.00
<i>Pakësimi i gjendjes cash</i>	<i>-1,500,000.00</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>194,283.45</b>
Kredi bankare në BKT në emër të Gerd Hoxha	

<sup>16</sup> Vërtetim nr.\*\*\*, datë 11.2.2021, i Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, depozituar nga subjekti së bashku me pyetësin e datës 5.2.2021.

<sup>17</sup> Vërtetim nr.\*\*\*, datë 11.02.2021, i Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, depozituar nga subjekti së bashku me pyetësin e datës 5.2.2021.

<sup>18</sup> Vërtetim nr.\*\*\*, datë 11.02.2021, i Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, depozituar nga subjekti së bashku me pyetësin e datës 5.2.2021.

Karta e kreditit	194,283.45
<b>Pasuri Neto</b>	<b>-194,283.45</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>146,739.33</b>
Paga në Gjykatën e rrethit Tiranë, subjekti deri më 15.6.2011	146,739.33
<b>SHPENZIMET</b>	<b>43,515.00</b>
Shpenzimet jetike deri më 15.6.2011	22,770.00
Udhëtimi jashtë vendit	20,745.00
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>297,507.78</b>

Pas kryerjes së analizës financiare, rezulton se, edhe pa i përfshirë në të ardhura shumë e deklaruar *cash* në vitin 2003 prej 1 500 000 lekësh, subjekti ka pasur mundësi për blerjen e pjesës takuese të tij në këtë apartament.

**26.5** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

**27. Apartament banimi<sup>19</sup>** me sipërfaqe 126.5 m<sup>2</sup>, (verandë + banesë) nr. pasurie \*\*\*/ND+\*-\*\*, zona kadastrale nr. \*\*\*, Vlorë, tërësisht i mobiluar dhe i gatshëm për shfrytëzim. Apartamenti është në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten znj. E.Ll dhe është blerë nga znj. A.Ç dhe z. A.Ç. Vlera 55.452 euro, pjesa takuese 50%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** shuma për blerjen e apartamentit është siguruar nga kursimet e subjektit dhe të ish-bashkëshortes së tij.

#### **Hetimi<sup>20</sup>/ Analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**27.1** Në datën 17.9.2016, me kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. \*\*\*, subjekti së bashku me ish-bashkëshorten e tij kanë blerë nga motra e ish-bashkëshortes dhe bashkëshorti i saj<sup>21</sup>, apartamentin me sipërfaqe 126.5 m<sup>2</sup>, në Vlorë, me nr. pasurie \*\*\*/+\*-\*\*, zona kadastrale \*\*\* për shumë 55.452 euro.

Pagesa<sup>22</sup> vërtetohet me depozitim në arkë, datë 9.9.2016 në llogarinë e noterit publik I. B të shumë 55.452 euro nga subjekti me emërtim “*Gerd Hoxha derdh lik çmim i shit të ap nr \*\*, sip 126.5 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*...*”

Ky apartament është blerë nga znj. A.Ç me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 31.03.2014, për shumë 7 627 950 lekë.

**27.2** Si burim për blerjen e këtij apartamenti subjekti ka deklaruar kursimet *cash* ndër vite të tij dhe ish-bashkëshortes së tij.

**27.2.1** Në DVP/2004 ish-bashkëshortja e subjektit znj. E. Ll deklaron kursime *cash* në shumë 5,000,000 lekë me burim kursimet e saj dhe të familjes dhuratë nga motra. Subjekti në lidhje me këtë shumë në përgjigje të pyetësorit të datës 5.2.2020 sqaron se:

<sup>19</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.9.2016; (ii) certifikatë pronësie nr. \*\*\*; (iii) vërtetim nga banka BKT me nr. extra prot., datë 20.1.2017; (iv) kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.6.2011; (v) kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.6.2011.

<sup>20</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.02.2019 drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 02.07.2020 drejtuar ASHK-së Vlorë; Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2020 ASHK-së Vlorë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar Bankave; Kthim përgjigje BKT-së nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019.

<sup>21</sup> A dhe A.Ç.

<sup>22</sup> Shkresë të BKT-së nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019.

Në vijim të pyetjes së Komisionit, i ka kërkuar informacion ish-bashkëshortes së tij znj.E. Ll, e cila gjithashtu ka qenë subjekt i rivlerësimit kalimtar, e cila i ka dhënë përgjigjen si më poshtë vijon:

*“Deklarata vjetore e vitit 2004 është edhe deklarata fillestare e hartuar nga ana e saj në cilësinë e detyrës së ushtruar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë...Kjo deklaratë pasqyron gjendjen e saj financiare dhe të ardhurat që ajo ka disponuar deri në fund të vitit 2004 që nga momenti i krijimit të tyre para fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtare, në kushtet kur për këtë vit kalendarik ka ushtruar detyrën e gjyqtares vetëm për muajt tetor, nentor dhe dhjetor 2004. Shuma në cash e deklaruar nga ana e saj në këtë deklaratë në vlerën 5 000 000 (pesë milion) lekë, përbëhet nga pagesa e bursës së akorduar nga Shkolla e Magjistraturës...në një total prej 772 790 lekësh. Njëkohësisht, për muajt tetor, nentor dhe dhjetor 2004, periudhë gjatë së cilës ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, ka përfituruar në total 192 453 lekë...*

*Që nga janari i vitit 2004 përveç ndjekjes së studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës ka ushtruar edhe detyrën e pedagoges së jashtme në Fakultetin e Drejtësisë pranë Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “L” me një pagë 25 000 lekë/muaj, të ardhura të cilat për vitin 2004 kanë qenë në shumën rreth 275 000 lekë...*

*Njëkohësisht pjesë e këtyre të ardhurave deri në fundin e vitit 2004, janë edhe të ardhurat e përfituara nga bursa e ekselencës për shkak të rezultateve maksimale në Fakultetin e Drejtësisë për vitet 1999-2002 në shumën 7500 lekë/muaj...Sipas përgjigjes së dhënë nga ana e administratës së këtij fakulteti me shkresën \*\*\* prot. dt. 15.10.2019, nga ana e këtij institucioni nuk disponohet dokumentacion lidhur me akordimin e kësaj burse apo të dhëna të tjera financiare për vitet 1999-2002, në kushtet kur të dhënat e vetme që ky institucion disponon, datojnë nga viti 2003 e në vazhdim. Për sa më sipër, në lidhje me këtë shumë ndodhet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së luajshme prej 225 000 lekësh, për shkak se vetë Fakulteti i Drejtësisë si institucioni që disponon informacionin lidhur me bursat e ekselencës të akorduara për studentët me rezultate maksimale, nuk ka të ruajtur në arkivën e tij të dhënat lidhur me vitet 1999-2002 kur edhe i është akorduar kjo bursë. Në kushtet kur ky Fakultet është i vetmi institucion që disponon këto të dhëna, përsa i përket kësaj shume deklaron se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për shkak se dokumenti nuk ekziston, nuk mund të bëhet përsëri e nuk mund të merret në rrugë tjetër, referuar nenit 32 pika 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

*Pjesa tjetër e shumës prej 5 000 000 (pesë milionë) lekë përbëhet nga kursimet e saj të përfituara nga motra znj. A.Ç dhe bashkëshorti i saj z. A.Ç. Kjo shumë përbëhet nga pagesat mujore që motra dhe bashkëshorti i saj i kanë dhënë nga viti i IV i Shkollës së Mesme deri në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 1997-2004, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/muaj, për shkak të ndihmesës që ka dhënë në biznesin familjar të qeradhënies. Në total kjo shumë për periudhën 8 –vjecare 1997-2004 e barabartë me 96 muaj, është 35 000 lekë/muaj x 96 muaj = 3 360 000 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Me familjarët e saj nuk ka patur një kontratë pune për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta familjare dhe këto shuma janë përfituruar si shpërblim mujor dhënë prej tyre.*

*Njëkohësisht me mbarimin e vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës me rezultate shumë të larta, motra e saj dhe bashkëshorti i saj i kanë dhuruar një shumë prej 2 000 000 (dy milion) lekë, pa kontratë, shumë e cila disponohej cash prej saj së bashku me kursimet e sipërcituara në vitin 2004 kur edhe ka bërë deklarimin e parë vjetor të të ardhurave që ka disponuar në formën e kursimeve deri në atë datë. Gjatë gjithë periudhës së sipërcituar, shpenzimet për jetesë janë përballuar nga të ardhurat e familjarëve të saj...shumat e sipërcituara janë kurse të saja ndër vite, të përfituara përpara se ajo të fillonte ushtrimin e detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë...*

Subjekti për të provuar të ardhurat e ish-bashkëshortes së tij në shumën 5,000,000 lekë ka depozituar:

- i. deklaratë noteriale nr. \*\*\*\*, datë 25.6.2018 e lëshuar nga znj. A. Ç dhe z. A.Ç, (motra dhe kunati i ish-bashkëshortes së tij znj. E.Ll)

Në këtë deklaratë këta shtetas deklarojnë se: *“Znj. E. Ll prej vitit IV të shkollës së mesme deri në vitin e II të shkollës së Magjistraturës ka qenë e punësuar pranë biznesit të tyre të ndërtimit dhe qeradhënies me pagë mujore 35, 000 lekë. Nuk kanë patur kontratë pune për shkak se ishte e punësuar në një biznes familjar.*

*Për shkak të mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për të ndihmuar daljen e saj në jetë i kanë dhuruar 2,000,000 lekë pa kontratë për shkak të marrëdhënies së posaçme që kanë patur midis tyre.”*

- ii. shkresë nr.\*\*\* prot., datë 29.10.2018, lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DTM, Tiranë

Sipas kësaj shkrese për periudhën 2003-2013 nga ana e DTM nuk disponohen informacion analitik lidhur me pagesat për tatimin mbi qiranë të ndarë sipas kontratave, ndërkohë për periudhën 2014-2017 ajo është si më poshtë:

Adresa	Kontrata	Periudha	Shuma qirase/euro	Tatimi mbajtur/euro
Rr. Abdyl Frashëri Tiranë	Nr. *** datë 22.05.2008	2014	102.000	10.200
Rr. Abdyl Frashëri Tiranë	Nr. *** datë 22.05.2008	2015	102.000	15.300
Rr. Abdyl Frashëri Tiranë	Nr. *** datë 22.05.2008	2016	102.000	15.300
Rr. Abdyl Frashëri Tiranë	Nr. *** datë 22.05.2008	2017	102.000	15.300

- iii. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26. 6.2018, e lëshuar nga z. Xh.Ll dhe znj. L. Ll, prindërit e ish-bashkëshortes E.Ll.

Në këtë deklaratë, këta shtetas deklarojnë se: *“Vazja e tyre, znj. E. Ll prej vitit IV të shkollës së mesme deri në vitin e II të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e punësuar pranë biznesit të ndërtimit dhe qiradhënies të motrës së saj A. Ç (Ll) me pagë mujore 35, 000 lekë. Nuk kanë pasur kontratë pune për shkak se ishte e punësuar në një biznes familjar.*

*Për shkak të mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për të ndihmuar daljen e saj në jetë motra e saj dhe bashkëshorti i kanë dhuruar 2,000,000 lekë pa kontratë për shkak të marrëdhënies së posaçme që kanë patur midis tyre.”*

**27.2.2** Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e familjes Ç. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen analiza financiare e familjes Ç deri në vitin 2004.

TË ARDHURAT E A. Ç DHE A.Ç	Totali
Të ardhura neto nga dhënia me qira e ambienteve Ambasadës Kroate	100,152,915.79
Tatim për qiranë	8,217,427.37



Të ardhura nga shitjet e pasurive	16,333,333.33
<b>Total i të ardhurave</b>	<b>116,486,249.12</b>
Shpenzime jetike	4,507,184.00
Shpenzime për blerje të pasurive të paluajtshme	51,278,355.54
Shpenzime për blerje të pasurive të luajtshme makina “Toyota”	1,503,680.00
Shpenzime për E. Ll paga mujore prej 35 000 lekë në muaj 1995-2004 dhe prika prej 2,000,000 lekë në 2004	5,780,000.00
Shpenzime për prindërit, pagesa prej 40,000 lekësh në muaj	7,200,000.00
<b>Total i shpenzimeve</b>	<b>70,269,219.54</b>
<b>TË ARDHURA NETO</b>	<b>46,217,029.58</b>
<b>MUNDËSI KUMULATIVE PËR KURSIM</b>	<b>46,217,029.58</b>

Në këtë analizë:

- Janë përfshirë vetëm të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e ambienteve që familja Ç kishte në pronësi në rrugën “M”, nr. \*\*\* Tiranë, Ambasadës së Republikës së Kroacisë, sipas kontratave të mëposhtme të qirasë:

	Periudha	Vlera e qirasë	Afati (muaj)	Totali në USD
Qira nga Ambasada Kroate	19.10.1993-20.10.1998	\$ 8,000.00	60	480,000.00
Qira nga Ambasada Kroate	20.10.1998-20.04.2001	\$ 8,500.00	30	255,000.00
Qira nga Ambasada Kroate	20.04.2001-20.10.2001	\$ 10,500.00	6	63,000.00
<b>Totali</b>				<b>798,000.00</b>

Në lidhje me këto të ardhura janë paraqitur si dokument provues:

- mandatarkëtimet të pagesës së tatimit mbi qiranë që z. A.Ç ka paguar pranë Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë në lekë. Në total shuma e derdhur si tatim mbi qiratë për periudhën 16.12.1996 - 1.10.1999 është 6,391,100.00 Lekë.
- mandatarkëtimet të pagesës së tatimit mbi qiranë që z. A. Ç ka paguar pranë Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë në USD. Në total shuma e derdhur, si tatim mbi qiratë për periudhën 21.12.1999 - 28.12.2000 është 12,809.00 USD.
  - Shpenzimet jetike janë llogaritur për 4 persona.
  - Si shpenzim është përfshirë dhe shuma 40,000 lekë si pagesa e dhënë për prindërit e subjektit.
  - Të dhënat për pasuritë e paluajtshme janë marrë nga përgjigjet e vëna në dispozicion nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, si rrjedhojë e hetimit të kryer nga Komisioni.

Komisioni pasi analizoi përgjigjet e subjektit vlerëson se z. A. Ç dhe znj. A. Ç (Ll) kanë të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumës prej 2,000,000 lekë ish – bashkëshortes së subjektit E. Ll në vitin 2004, siç dhe kanë deklaruar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.6.2018. Gjithashtu ato kanë të ardhura të mjaftueshme dhe për pagesën mujore në shumën 35,000 lekë të pagesës së pretenduar nga ish-bashkëshortja e subjektit.

**27.2.3** Në lidhje me burimin e shumës 5,000,000 lekë të ish-bashkëshortes së subjektit, Komisioni ka konstatuar dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit për mospërputhjen e

deklarimeve se: (i) zonja Ll në DVP/2004 ka deklaruar si burim për këtë shumë kursimet e saj dhe të familjes, dhuratë nga motra; (ii) në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.6.2018 të lëshuar nga znj. A. Ç dhe z. A.Ç, si burim i kësaj shume deklarohen, përveç vlerës 2,000,000 lekë të dhuruar, edhe të ardhurat e zonjës Ll nga punësimi pranë biznesit të tyre të ndërtimit dhe qiradhënies me pagë mujore 35, 000 lekë.

**27.2.4** Në parashtrimet e tij, subjekti i ka kërkuar Komisionit t'i referohet gjetjeve dhe konkluzioneve të KPK-së, në lidhje me këtë çështje, e cila është trajtuar nga një trup tjetër e KPK-së. Ai deklaron se ish-bashkëshortja e tij ka ardhur me të ardhurat e saj, të cilat në dijeninë e tij i ka pasur dhuratë nga familja e motrës së saj për një pjesë të shumës, ndërsa pjesa tjetër ka qenë në formën e shpërblimit kryesisht nga angazhimi i saj në aktivitetin tregtar të familjes së motrës së saj. Duke iu referuar dhe deklarimeve të saj në DVP/2004, ish-bashkëshortja e ka cilësuar se ka patur kursime *cash* në shumën 5,000,000 lekë, kursime të cilat janë rritur më pas nga viti 2006 e në vijim... Këto kursime *cash* në shumën 5,000,000 lekë kanë ardhur në formë dhurimi në shumën 2,000,000 lekë dhe 3,000,000 lekë përbëjnë të ardhurat e saj, ku përfshihen mes të tjerave dhe të ardhurat në formë shpërblimi nga angazhimi i saj në aktivitetin tregtar të familjes së motrës së saj. Megjithatë ai nuk është në gjendje aktualisht të japë shpjegime më të detajuara apo shteruese në lidhje me këtë shumë.

**27.2.5** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të theksojë faktin se procesi i rivlerësimit i subjektit është një proces i ndarë nga ai i ish-bashkëshortes së tij dhe konkluzionet e një trup tjetër gjykues nuk mund të ndikojnë në vlerësimin e trupës në lidhje me shumën 5,000,000 lekë. Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin e mësipërm ka kryer një hetim të pavaruar nga trupa tjetër dhe konkludon se shuma 5,000,000 lekë duhet të përfshihet në analizë financiare për arsyet e mëposhtme:

- i. burimi i ligjshëm i kësaj shumë pavarësisht faktit nëse kemi të bëjmë me një dhurim apo marrëdhënie punësimi është i provuar, pasi familja Ç ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 2,000,000 lekë si dhe kryerjen e pagesës mujore të znj. Ll. Gjithashtu ish-bashkëshortja e subjektit ka përfituar të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës në shumën 772,790 lekë, si dhe pagë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në shumën 192,453 lekë;
- ii. në lidhje me marrëdhënien e punësimit, bazuar në shpjegimet e subjektit, ajo ka qenë një marrëdhënie e posaçme familjare ku familja Ç shpërblente znj. Ll për shkak të angazhimit të saj/ndihmës në biznesin e tyre;
- iii. kjo shumë është siguruar përpara fillimit të detyrës së znj. Ll, gjatë kohës që ajo ishte studente;
- iv. shuma prej 5,000,000 lekësh është deklaruar nga znj. Ll që në vitin 2004, deklarinimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016;
- v. të ardhurat e mësipërme janë krijuar përpara se subjekti i rivlerësimit të martohej me znj. Ll;
- vi. Pavarësisht se subjekti nuk ka pasur dijeni për mënyrën e krijimit të kësaj shume, nuk ka kontribuar në krijimin e saj, por edhe nuk ka përgjegjësi në lidhje me krijimin dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj, për sa kohe ajo është krijuar përpara martesë, nga hetimi i kryer nga Komisioni, kjo shumë rezultoi e krijuar me burime të ligjshme financiare.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se pavarësisht mospërputhjes të konstatuar midis deklaratës noteriale dhe deklarimeve të znj. Ll në DVP/2004 në lidhje me burimin e shumës 5,000,000 lekë, ajo nuk sjell si pasojë mosnjohjen e të ardhurave të ligjshme të familjes Çiraku për sa kohë subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Në vështrim të Aneksit D pika 5 të Kushtetutës, mospërputhjet në deklarime

nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore apo të sjellin pasoja për subjektet për sa kohë ato nuk janë përpjekur të fshehin apo të deklarojnë në mënyrë të pasaktë pasurinë.

**27.3** Në deklarinimin para fillimit të detyrës, në vitin 2003, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 2 500 000 lekë. Më pas, në deklaratat periodike nga viti 2004-2010, subjekti ka deklaruar kursime *cash* përkatësisht:

në vitin 2004 – deklaroi se ka gjendje 1,500,000 lekë;

në vitin 2005 – 350 000 lekë;

në vitin 2006 – 600 000 lekë<sup>23</sup>;

në vitin 2007 - 100 000 lekë;

në vitin 2008 – 200 000 lekë;

në vitin 2009 - 400 000 lekë;

në vitin 2010 – 350 000 lekë.

Nga analiza financiare më poshtë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursimet *cash* për periudhën 2005-2011, në shumën 2,000,747.68 lekë<sup>24</sup>.

---

<sup>23</sup> Subjekti në DVP/2007 ka qartësuar që kjo shumë është kursim *cash*.

<sup>24</sup> Kjo shumë është llogaritur përpara kalimit të barrës së provës.

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
<b>PASURITË</b>	<b>50,424.00</b>	<b>0.00</b>	<b>286,169.00</b>	<b>708,192.61</b>	<b>1,536,426.53</b>	<b>205,851.39</b>	<b>412,506.28</b>	<b>359,335.03</b>	<b>6,210,958.90</b>
Makine Mercedes Benz		1,149,278.32							
Makine Daimlerchrysler					1,500,000.00				
Apartament sip125 m2									6,500,000.00
<i>Shtesa / pakesime të likujditeteve Cash dhe banke</i>	<i>50,424.00</i>	<i>-1,149,278.32</i>	<i>286,169.00</i>	<i>708,192.61</i>	<i>36,426.53</i>	<i>205,851.39</i>	<i>412,506.28</i>	<i>359,335.03</i>	<i>-289,041.10</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>5,194,283.45</b>
Kredi bankare ne BKT									5,000,000.00
Pagesat e principal Kredise ne BKT									
Karta e Kreditit									194,283.45
<b>PASURI NETO</b>	<b>50,424.00</b>	<b>0.00</b>	<b>286,169.00</b>	<b>708,192.61</b>	<b>1,536,426.53</b>	<b>205,851.39</b>	<b>412,506.28</b>	<b>359,335.03</b>	<b>1,016,675.45</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTA</b>	<b>50,424.00</b>	<b>846,706.00</b>	<b>879,646.00</b>	<b>924,830.00</b>	<b>2,327,138.00</b>	<b>988,011.00</b>	<b>902,327.00</b>	<b>869,854.00</b>	<b>2,080,436.00</b>
Te ardhurat e subjektit	50,424.00	846,706.00	879,646.00	924,830.00	997,128.00	988,011.00	902,327.00	869,854.00	880,436.00
Te ardhura nga shitja e makines Makine Mercedes Benz					1,330,010.00				
Te ardhura nga shitja e makines Daimlerchrysler									1,200,000.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>7,830.33</b>	<b>161,136.20</b>	<b>186,757.20</b>	<b>312,429.92</b>	<b>340,042.90</b>	<b>502,472.03</b>	<b>451,419.15</b>	<b>521,123.70</b>	<b>614,748.99</b>
Shpenzimet jetike	7,830.33	93,964.00	109,557.00	109,557.00	136,620.00	136,620.00	136,620.00	136,620.00	136,620.00
Pagesat e interesave Kredise BKT									101,182.91
Shpenzim Sigurim jete dhe prone per kredine ne BKT									58,154.01
Udhetime jashtë vendit TIMS		67,172.20	77,200.20	202,872.92	203,422.90	365,852.03	314,799.15	384,503.70	318,792.07
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>42,593.67</b>	<b>685,569.80</b>	<b>406,719.80</b>	<b>-95,792.53</b>	<b>450,668.57</b>	<b>279,687.59</b>	<b>38,401.57</b>	<b>-10,604.73</b>	<b>449,011.56</b>

## 27.4 Analiza Financiare për blerjen e apartamentit

Vitet	1.1.2016-17.9.2016
<b>PASURITË</b>	<b>1,114,013.94</b>
Apartament sip.125 m <sup>2</sup>	7,500,992.04
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-6,386,978.1000</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>-105,069.05</b>
Kredi bankare BKT	
Pagesat e kredisë principal	-105,069.05
Detyrime të likuiduara për “Tirana Leasing”	
<b>PASURI NETO</b>	<b>1,219,082.99</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,198,651.25</b>
Të ardhurat e subjektit	1,061,577.75
Të ardhura të pagës znj. E. Ll	866,533.50
Tërheqja e pagesës në UET për studime doktorature	270,540.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>1,951,073.85</b>
Shpenzimet jetike	705,276.00
Pagesat e interesave kredisë BKT	133,936.57
Shpenzim sigurim jete dhe prone për kredinë në BKT	20,329.00
Shpenzime për shkollim të fëmijëve	374,000.00
Udhëtimi jashtë vendit TIMS	467,532.28
Shpenzime për pushime brenda dhe jashtë vendit	250,000.00
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>-971,505.59</b>

Në analizë janë konsideruar si kursime *cash*:

- i. Gjendje *cash* të ish- bashkëshortes së subjektit zj. E. Ll, sa më poshtë :
  - a. kursimet *cash* në shumën 5,000,000 lekë të deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës;
  - b. janë konsideruar si kursime *cash* shumat e paraqitura në DVP periodike të ish-bashkëshortes së subjektit zj. E.Ll në vlerën 1,000,000 lekë;
  - c. të provuara me dokumentacion komform ligjit gjendja *cash* është në total 6,000,000 lekë.
- ii. Gjendja *cash* e subjektit në shumën 576,747.68 lekë mbetur pas blerjes së apartamentit në vitin 2011.
- iii. Shtesat dhe pakësimet e gjendje *cash* pas martesës.
- iv. Në analizë janë konsideruar si burim të ardhurash:
  - a. të ardhurat e subjektit (si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si anëtar i KLD-së dhe si pedagog dhe ekspert në Shkollën e Magjistraturës);
  - b. të ardhurat e ish -bashkëshortes (si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
  - c. të ardhurat nga tërheqja e pagesës në UET për studime doktorature.

**27.4.1** Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti në shumën 971,505.59 lekë.

**27.4.2** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se:

...Komisioni nuk ka konsideruar të paktën disa kategori të kursimeve *cash*, ndër vite, si më poshtë vijon:

- i. Të ardhurat në shumën prej 1,500,000 lekësh nga puna në sektorin privat dhe vetëpunësim;
- ii. Të ardhurat në shumën prej 1,200,000 lekësh nga shitja e automjetit me targë TR\*\*\*N.

Komisioni, në analizën dhe gjetjet e tij, nuk ka marrë në konsideratë si shtesë në gjendjen *cash*, të ardhurat në shumën prej 1,200,000 lekësh, përfituar nga shitja e automjetit tip “M. B” me

targë TR \*\*\* N shtetasit E.G., nëpërmjet kontratës së premtimit të shitjes nr. \*\*\*rep., nr.\*\*\* kol., datë 31.3.2011 dhe kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2011.

Ky transaksion është pasqyruar në mënyrë të rregullt në deklarin periodik vjetor për vitin 2011 dhe në deklaratën “Vetting” të vitit 2016 prej tij dhe ish-bashkëshortes së tij. Ai është paraqitur pikërisht në kolonën përkatëse të ndryshimit të pasurive dhe burimit të krijimit të tyre, në formularin periodik vjetor, ku ai ka deklaruar shitjen e këtij automjeti dhe të ardhurat e krijuara në vlerën 1,200,000 lekë. Qëllimi i tij i vetëm ka qenë deklarimi i saktë dhe transparent i këtij transaksioni dhe trajtimi i kësaj vlere si shumë *cash*, e cila fillon dhe kursethet në momentin e marrjes prej tij të vlerës monetare nga blerësi. Në këtë rast pasuria “automjet”, është konvertuar në gjendje para, në vlerën e shitjes prej 1,200,000 lekësh, mjete të cilat nuk u shpenzuan, por u përdorën si gjendje *cash* kursimi në atë moment, dhe në vazhdim.

Në asnjë dokument, apo rrethanë tjetër, ai nuk ka deklaruar apo pranuar shpenzimin e menjëhershëm, apo aty për aty të kësaj shume të përfituar nga shitja, apo të lë të kuptoj se kjo shumë është shpenzuar në të njëjtin vit kalendarik (2011). Ajo shumë i është bashkuar gjendjes së kursimeve të tjera...Komisioni ka pasur mundësinë të konstatojë se nuk ka rezultuar asnjë shtesë tjetër në pasuri të tjera, të luajtshme apo të paluajtshme në atë vit kalendarik, për të cilat mund të ishte përdorur kjo shtesë në kursime, çka qartësisht nënkupton se kjo vlerë është shtuar në kursimet ekzistuese, për vitin në vazhdim. Në mënyrë tërësisht të logjikshme dhe evidente, kjo shumë është përdorur më pas për krijimin e pasurive të tjera, përfshirë këtu pagesën e një pjese të çmimit të blerjes së automjetit tip “C”, në vitin 2012 dhe të pasurive të tjera. Një pjesë e kësaj shume të gjendjes së kursimit së bashku me kursime të tjera janë përdorur pak muaj më vonë për të paguar një pjesë të çmimit të automjetit të radhës “C. C\*”. Në përputhje me sa më sipër, vlera negative e aluduar prej (-) 687,222.17 lekësh në lidhje me blerjen e automjetit “C” pak muaj më vonë në vitin 2012 nuk mund të ekzistojë dhe në këtë rast kemi një balancë pozitive prej (+) 512,777.83 lekësh, pas blerjes së këtij automjeti...

Në konkluzion subjekti ka kërkuar që Komisioni të konsiderojë si kursim shumë prej 1,200,000 lekësh në vitin 2011, duke ia shtuar këtë shumë gjendjes ekzistuese të kursimeve *cash*.

### **iii. Të ardhura të tjera të kursyera *cash*, të deklaruara në deklarinet periodike vjetore për ish-bashkëshorten**

Komisioni nuk ka përfshirë dhe si pasojë nuk ka përlllogaritur, kursimet *cash* ndër vite nga të ardhurat e ligjshme të ish-bashkëshortes së tij, të cilat janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe ligjore në deklarinet periodike vjetore... Në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë:

#### **Për vitin 2006 – janë deklaruar:**

- i. kursime nga paga si gjyqtare në vlerën 450,000 lekë;
- ii. kursime nga paga si pedagoge në vlerën 360,000 lekë;
- iii. shtesa nga shitja e automjetit në vlerën 400,000 lekë;
- iv. pakësime për blerje automjeti në vlerën 250,000 lekë;

Në total për vitin 2006 kursimet *cash* janë në vlerën 960,000 lekë.

Subjekti, në seancën e datës 1 qershor ka saktësuar se ish-bashkëshortes i ka tepruar një shumë prej 150,000 lekësh nga shitja e automjetit, si dhe kursimet nga paga si pedagoge në total 510,000 lekë, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

#### **Për vitin 2007 – janë deklaruar:**

- i. kursime nga të ardhurat nga paga si gjyqtare në vlerën 150,000 lekë;
- ii. kursime nga të ardhurat nga paga si pedagoge në vlerën 300,000 lekë

Në total për vitin 2007 kursimet *cash* janë në vlerën 450,000 lek.

Subjekti, në seancën e datës 1 qershor ka saktësuar se ish-bashkëshortja ka kursyer dhe shumën 300,000 lekë.

**Për vitin 2008 – janë deklaruar:**

- i. kursime nga të ardhurat nga paga si gjyqtare në vlerën 200,000 lekë;
- ii. kursime nga të ardhurat nga paga si pedagoge në vlerën 25,000 lekë.

Në total për vitin 2008 kursimet *cash* janë në vlerën 225,000 lekë.

Subjekti, në seancën e datës 1 qershor ka saktësuar se ish-bashkëshortja ka kursyer dhe shumën 25,000 lekë.

**Për vitin 2010 – janë deklaruar:**

- i. kursime nga paga si gjyqtare *cash* në vlerën 200,000 lekë;
- ii. të ardhura nga shitja e automjetit, në vlerën 500,000 lekë.

Në total për vitin 2010 kursimet *cash* janë në vlerën 700,000 lekë.

Subjekti, në seancën e datës 1 qershor ka saktësuar se ish-bashkëshortja ka kursyer dhe të ardhurat nga shitja e makinës.

Në seancën e datës 1 qershor subjekti ka kërkuar përfshirjen e shumës 200,000 lekë të deklaruar nga ish-bashkëshortja në DVP/2011...

Në lidhje me kursimet *cash* të ish-bashkëshortes, subjekti, në seancën e datës 1.6.2021, ka pretenduar se mënyra e deklarimit të bashkëshortes së tij ka të njëjtën logjikë në të gjitha vitet ku ajo ka deklaruar kursime *cash*, në kolonën e deklarimit periodik me emërtimin “Ndryshimi i interesave privatë”. Pra, kursimet *cash* nuk vijnë vetëm nga paga si gjyqtare, por dhe nga paga si pedagoge, apo nga të ardhura të tjera si p.sh. shitja e automjetit.

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni, që bazuar në faktet dhe analizën e mësipërme, të konsiderojë shumën shtesë të kursimeve.

**27.4.3 Nga shqyrtimi i provave dhe shpjegimeve të subjektit, rezulton se:**

**27.4.3.1** Në lidhje me kursimet *cash* të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i deklaratave të interesave private periodike rezulton se ish-bashkëshortja e subjektit në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ka deklaruar si më poshtë:

Viti	Seksioni “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”	Seksioni “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”
2006	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga si gjyqtare në vlerën 450,000 lekë;</li> <li>• të ardhura si pedagoge në vlerën 360,000 lekë;</li> <li>• të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 400,000 lekë;</li> <li>• blerë automjet në vlerën 250,000 lekë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare 900,000 lekë</li> <li>• të ardhura nga paga mujore si pedagoge 45,000 lekë/muaj</li> </ul>
2007	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga si gjyqtare në vlerën 150,000 lekë</li> <li>• të ardhura nga paga si pedagoge në vlerën 300,000 lekë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare 825,442 lekë</li> <li>• të ardhura nga paga mujore si pedagoge janar-korrik 45,000 lekë/muaj, nëntor-dhjetor 15,000 lekë/muaj</li> </ul>
2008	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga si gjyqtare (819 755 lekë/vit) në vlerën 200,000 lekë</li> <li>• të ardhura si pedagoge në vlerën 25,000 lekë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare 819 755 lekë/vit tek shuma deklaroi 200,000 lekë</li> <li>• të ardhura nga paga si pedagoge vetëm muajt janar-shkurt në vlerën 25,000 lekë</li> </ul>

2010	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kursime nga paga si gjyqtare në vlerën 200,000 lekë</li> <li>• përfituar të ardhura nga shitja e automjetit, në vlerën 500,000 lekë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ardhura nga paga si gjyqtare për periudhën 1 vjeçare 810,000 lekë</li> <li>• Të ardhura nga shitja e automjetit 500,000 lekë</li> </ul>
2011	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kursime nga paga si gjyqtare në vlerën 200,000 lekë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• paga si gjyqtare 858,557 lekë</li> </ul>

Komisioni, bazuar në analizimin e deklarimeve periodike të ish-bashkëshortes së subjektit konstaton një model të njëjtë deklarimi të kursimeve të saj për periudhën 2006-2011. Ish-bashkëshortja e subjektit në seksionin “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, (seksioni në të cilën deklarohen ndër të tjera dhe shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash*) nga ana e saj ka deklaruar në mënyrë të njëjtë për të gjitha vitet kursimet *cash* vjetore në formën e të ardhurave, duke cilësuar dhe burimet përkatëse. Në vitin 2006 në seksionin “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ajo deklaroi të ardhura nga paga si gjyqtare 450,000 lekë ndërkohë që në seksionin “Të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private” deklaroi të ardhurat vjetore nga paga si gjyqtare janë 900,000 lekë, i njëjti deklarim bëhet dhe për të ardhurat si pedagoge si dhe nga shitja e automjeteve. Këtë formë deklarimi ish-bashkëshortja e subjektit e ka bërë për të gjithë vitet në vazhdim. Mbështetur në këtë model deklarimi të ish-bashkëshortes së subjektit Komisioni vlerëson të pranojë shpjegimet e subjektit, duke pranuar që çdo e ardhur e deklaruar nga ish-bashkëshortja e tij në seksionin “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” do të konsiderohet si shtim i gjendjes *cash* në vitin përkatës të deklarimit. Në lidhje me kursimet *cash* të ish-bashkëshortes Komisioni do të përfshijë në analizën financiare shumën 5,000,000 lekë të deklaruar në vitin 2004 nga ana e saj dhe shumën 2,535,000 lekë si total i kursimeve *cash* të deklaruara në vitet 2006-2012.

**27.4.3.2** Në lidhje me të ardhurat në shumën prej 1,200,000 lekësh përfituar nga shitja e automjetit me targë TR \*\*\* N, Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- i. subjekti, në DPV/2011, në seksionin “Ndryshim i interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar shitjen e kësaj makine në shumën 1,200,000 lekë;
- ii. subjekti, në DPV/2011, nuk rezulton të ketë deklaruar se shuma 1,200,000 lekë është përdorur si burim për blerjen e ndonjë pasurie apo të jetë shpenzuar për nevoja të tjera të subjektit;
- iii. subjekti nuk rezulton që të ketë deklaruar në DVP/2011 shpenzime në vlerën mbi 300,000 lekë;
- iv. nga hetimi ka rezultuar se në vitin 2011 subjekti nuk ka blerë pasuri të luajtshme/të paluajtshme, nuk ka shtuar likuiditet në bankë si dhe del me një rezultat pozitiv rreth 1,600,000 lekë;
- v. subjekti, në DPV/2012, në lidhje me burimin e automjetit tip “C”, deklaroi si burim kursimet personale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit se subjekti nuk ka deklaruar shprehimisht se shuma 1,200,000 lekë është kursim *cash*, kjo shumë do të konsiderohet si shtesë në gjendjen *cash* të subjektit, për sa kohë (i) ai rezulton të ketë deklaruar në seksionin ku deklarohet shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* shitjen e automjetit dhe shumën përkatëse të shitjes 1,200,000 lekë, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e parashikuar nga neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar; (ii) nga hetimi ka rezultuar se kjo shumë nuk është përdorur si burim për blerjen e ndonjë pasurie për vitin 2011 apo të jetë deklaruar nga subjekti si pakësim në këtë vit; (iii) subjekti nuk kishte detyrimin



ligjor për të shtuar dhe një rresht tjetër në seksionin “Ndryshim i interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” me qëllim deklarimin se shtesat në gjendjen *cash* për vitin 2011 ishin 1,200,000 lekë, pasi vetë deklarimi i shumës së shitjes së automjetit në këtë seksion përfshin dhe deklarimin se kemi të bëjmë me shtim të gjendjes *cash*.

Komisioni konsaton se dhe nëse kjo shumë nuk përfshihet në analizë financiare, nuk ndikon negativisht në rezultatin final financiar të subjektit.

**27.5** Në përfundim, në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, pas përfshirjes në analizë të: (i) kursimeve *cash* të deklaruar ndër vite nga ish-bashkëshortja e tij; (ii) konsiderimit si kursime *cash* në vitin 2004 të shumës 1,500,000 lekë, duke pranuar të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme e subjektit për periudhën 1995-2000; (iii) shumës 1,200,000 lekë si shtesë e gjendjes *cash* e subjektit në vitin 2011; rezulton se ai së bashku me ish-bashkëshorten e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës.

Vitet	1.1.2016 - 17.9.2016
<b>PASURITË</b>	<b>0.00</b>
Apartament sip. 125 m <sup>2</sup>	7,500,992.04
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-7,500,992.0400</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>-105,069.05</b>
Kredi bankare në BKT	-
Pagesat e Kredise principal	-105,069.05
Detyrime të likuajuara për Tirana Leasing	-
<b>PASURI NETO</b>	<b>105,069.05</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,198,651.25</b>
Të ardhurat e subjektit	1,061,577.75
Të ardhura të pages znj. E.LI	866,533.50
Tërheqja e pagesës në UET për studime doktrature	270,540.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>2,024,754.85</b>
Shpenzimet jetike	528,957.00
Pagesat e interesave të kredisë në BKT	133,936.57
Shpenzim sigurim jete dhe prone për kredinë në BKT	20,329.00
Shpenzime për shkollim të fëmijëve	374,000.00
Udhetimi jashtë vendit TMS	467,532.28
Shpenzime për pushime brenda dhe jashtë vendit	500,000.00
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>68,827.35</b>

**27.6** Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

**28. Automjet tip “T”<sup>25</sup>**, në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten znj. E.LI. Vlera 5.000 euro, pjesa takuese 50%, blerë në vitin 2016.

<sup>25</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë shitje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2016; (ii) kontratë shitje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.11.2016; (iii) kontratë themelore e qirasë

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** blerë nga shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “C. C\*”, me targë AA \*\*\* EO.

## Hetimi<sup>26/</sup> analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni, për këtë pasuri

**28.1** Në datën 29.12.2016, me kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\*, subjekti dhe ish-bashkëshortja e tij kanë blerë nga bashkëshorti i motrës së znj. E. Ll automjetin “T. R\*”, për çmimin 5.000 euro.

**28.1.1** Pagesa e automjetit vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë në monedhën euro në bankën BKT, në emër të subjektit, në të cilën rezulton se në datën 27.12.2016 është transferuar shuma 5.000 euro, në llogari të shtetasve A ose A.Ç për pagesë për blerje automjeti “T” me targë TR \*\*\* T.

**28.1.2** Si burim për blerjen e këtij automjeti subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “C”.

Në datën 10.11.2016, me kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\* subjekti ka shitur automjetin tip “C. C\*”, për çmimin 10.500 euro. Pagesa konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë në monedhën euro në bankën BKT, në emër të subjektit, në të cilën rezulton se në datën 15.11.2016 është transferuar shuma 10.489,5 euro, nga personi fizik “R.S”, për pagesë makine.

**28.1.3** Në përfundim të analizës për mundësitë e blerjes së automjetit tip T. R\*, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

**28.1.4** Komisioni ka analizuar burimin e blerjes së automjetit “C. C\*”, që ka shërbyer si burim për automjetin “T. R\*”.

Subjekti me anë të kontratës themelore të qirasë financiare Leasing nr. \*\*\* kol., datë 16.8.2012 ka blerë automjetin tip C në shumën 16.500 euro.

Bazuar në shtojcën nr. 1 të kësaj kontrate parashikohet se 54.5% e vlerës përfundimtare të sendit<sup>27</sup> është paguar, ndërkohë që shuma e qirasë për t’u paguar është 7.500 euro.

Në datë 22.09.2016 është lidhur kontratë e shitjes së automjetit me nr. \*\*\*\*, datë 22.9.2016, për blerjen e automjetit tip C. C\*, me targa AA \*\*\* EO, me çmimin 1.623,41 euro.

## Analizë financiare

<b>Vitet</b>	<b>16.08.2012</b>
<b>PASURITË</b>	<b>8,367,519.20</b>
Makinë, tip “C C*” AA *** EO	2,305,380.00
Shtesa / pakësime të likuiditeteve <i>cash</i> dhe bankë	6,062,139.20
<b>DETYRIME</b>	<b>834,164.68</b>
Kredi bankare në BKT	0.00
Pagesat e principal kredisë në BKT	-118,799.77
Deyrim i mbetur pas shlyerje detyrimi i pjesshëm te “Tirana Leasing” për makinën “Citroen”	1,047,900.00
Detyrime të likuiduara për “Tirana Leasing”	-94,935.55
<b>PASURI NETO</b>	<b>7,533,354.52</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>7,389,908.67</b>
Të ardhurat e subjektit	604,088.00
Të ardhura të pagës E. Ll	785,820.67
Të ardhura dhuratë nga të afërmit (prikë) e E. Ll	6,000,000.00

financiare *leasing* nr. \*\*\*, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.8.2012; (iv) nxjerrje e llogarisë në monedhën euro në bankën BKT, në emër të shtetasit Gerd Hoxha.

<sup>26</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor; kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2019; kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2019; shkresë nr.\*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar bankave; Kthim përgjigjeje BKT-ja nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019; kthim përgjigjeje “Raiffeisen Leasing” sh.a nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2019.

<sup>27</sup> Në DVP/2012 subjekti deklaroi se ka parapaguar shumën 9.000 euro.

<b>SHPENZIMET</b>	<b>543,776.32</b>
Shpenzimet jetike	197,693.00
Pagesat e interesave të kredisë në BKT	116,808.01
Shpenzim sigurim jete dhe prone për kredinë në BKT	19,957.00
Udhëtimi jashtë vendit TIMS	209,318.31
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>-687,222.17</b>

**28.1.5** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit “C. C\*” në shumën 687,222.17 lekë.

**28.1.6** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka arsyetuar se nëse nga ana e Komisionit do të përfshiheshin në analizë financiare të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme gjatë viteve 1995-2000, kursimet *cash* në shumën 1,200,000 lekë të përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2011, si dhe kursimet *cash* sikundër janë deklaruar nga bashkëshortja e tij në deklaratat periodike ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Më në detaje shpjegimet e subjektit janë trajtuar në pikën 27.4.2.

**28.1.7** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke u mbështetur në analizën e kryer më lart në lidhje me të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për periudhën 1995-2000 trajtuar në pikën 26.3.5 të këtij vendimi dhe të ardhurat nga shitja e automjetit dhe kursimet *cash* të bashkëshortes së tij trajtuar në pikën 27.4.3, vlerëson të përfshijë në analizë financiare këto të ardhura.

Si burim për blerjen e këtij automjeti, subjekti, në DVP/2012, ka deklaruar kursimet personale të tij dhe të bashkëshortes së tij. I njëjti deklaram është bërë dhe nga ish-bashkëshortja e subjektit.

Mbështetur në deklaramet e subjektit, si dhe shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, Komisioni do të zbrësë nga gjendja *cash* e subjektit dhe bashkëshortes së tij vlerën e automjetit duke u konsideruar si pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2012.

Vitet	16.08.2012
<b>PASURITË</b>	<b>8,645,039.20</b>
Makinë tip “C. C*” AA *** EO	2,305,380.00
<i>Shtesa / pakesime të likuiditeteve cash dhe bankë</i>	<i>6,339,659.20</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>834,164.68</b>
Kredi bankare në BKT	0.00
Pagesat e principal kredisë në BKT	-118,799.77
Deyrim i mbetur pas shlyerje detyrimi i pjesshëm te “Tirana Leasing” për makinën “Citroen”	1,047,900.00
Detyrime të likuiduara për “Tirana Leasing”	-94,935.55
<b>PASURI NETO</b>	<b>7,810,874.52</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>8,924,908.67</b>
Të ardhurat e subjektit	604,088.00
Të ardhura të pagës E. Ll	785,820.67
Të ardhura dhuratë nga të afërmit (prikë) e E. Ll	7,535,000.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>543,776.32</b>
Shpenzimet jetike	197,693.00
Pagesat e interesave së kredisë BKT	116,808.01
Shpenzim sigurim jete dhe prone për kredinë në BKT	19,957.00
Udhëtimi jashtë vendit TIMS	209,318.31
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>570,257.83</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

**28.2** Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me automjetin tip T. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

**28.3** Në datën 7.5.2007, subjekti, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, ka blerë automjetin<sup>28</sup> tip “D. C” për shumën 1,500,000 lekë.

**28.3.1** Nga analiza financiare rezulton se:

Vitet	<b>7 Maj 2007</b>
<b>PASURITË</b>	<b>1,599,985.06</b>
Makinë “D” TR *** N	1,500,000.00
Shtesa / pakësime të likuiditeteve	99,985.06
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>1,599,985.06</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>1,745,480.00</b>
Të ardhurat e subjektit 1995-2000	0.00
Të ardhurat e subjektit	415,470.00
Te ardhura nga shitja e makinës “Mercedes – Benz”, TR ***K	1,330,010.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>135,810.60</b>
Shpenzimet jetike	56,925.00
Udhetimi jashtë vendit TMS	78,885.60
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>9,684.34</b>

Ky automjet<sup>29</sup> është shitur më 31.03.2011 me kontratë premtim shitjeje nr.\*\*\*\*, për shumën 1,200,000 lekë. Në këtë kontratë është deklaruar se 1,000,000 lekë janë paguar me nënshkrimin e kontratës, ndërsa 200,000 lekë në një periudhë të mëvonshme. Në datën 29.10.2011 është lidhur kontrata e shitjes nr. \*\*\*\*, për këtë automjet.

Subjekti në DVP/2011 në seksionin “Ndryshim i interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ka deklaruar shitjen e kësaj makine në shumën 1,200,000 lekë.

**28.3.2** Kjo shumë nuk do të konsiderohet si shtesë në gjendjen cash të subjektit për sa kohë ai nuk e ka deklaruar shprehimisht që kjo shumë është kursim cash. Për këtë iu kërkuan shpjegime bindëse subjektit.

**28.3.3** Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se ky transaksion është pasqyruar në mënyrë të rregullt në deklaramin periodik vjetor për vitin 2011 dhe në deklaramin Vetting të vitit 2016 prej tij dhe ish-bashkëshortes. Ai është paraqitur pikërisht në kolonën përkatëse të Ndryshimit të Pasurive dhe burimit të krijimit të tyre, në formularin periodik vjetor, ku ai ka deklaruar shitjen e këtij automjeti dhe të ardhurat e krijuara në vlerën 1,200,000 lekë... Më në detaje shpjegimet e subjektit janë trajtuar në pikën 27.4.2/ii të këtij vendimi.

**28.3.4** Pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e tij janë bindëse, duke e konsideruar shumën 1,200,000 si shtesë në kursimet *cash* për arsyet e trajtuar në pikën 27.4.3.2 të këtij vendimi.

**28.4** Në datën 1.11.2004 subjekti ka blerë automjetin “Benz”<sup>30</sup> për çmimin 5900 euro. Në DVP/2004 subjekti deklaron se ka paguar dhe shumën 400,000 lekë si detyrim doganor.

Ky automjet është shitur<sup>31</sup> me kontratën nr.\*\*\*\*, datë 5.5.2007 për shumën 11.000 euro.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit:

<b>Analizë blerje makine “Mercedes –Benz” TR ***K</b>	<b>1.1. -1.11.2004</b>
-------------------------------------------------------	------------------------

<sup>28</sup> Deklaruar në DVP/2007.

<sup>29</sup> Deklaruar në DVP/2011.

<sup>30</sup> Deklaruar në DVP/2004.

<sup>31</sup> Deklaruar në DVP/2007.

<b>PASURITË</b>	-
Makinë “Mercedes – Benz” TR ***K në pronësi të Gerd Hoxha	1,149,278.32
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve</i>	<i>(1,149,278.32)</i>
<b>DETYRIME</b>	-
<b>PASURI NETO</b>	-
<b>TË ARDHURA</b>	<b>782,696.17</b>
Të ardhurat e Gerd Hoxha 1994-2000	-
Të ardhurat e subjektit	782,696.17
<b>SHPENZIMET</b>	<b>153,305.87</b>
Shpenzimet jetike	86,133.67
Udhëtimi jashtë vendit	67,172.20
Shpenzime pagese taksë zhdoganimi	-
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>629,390.30</b>

**28.5** Me kontratën<sup>32</sup> nr. \*\*\*\*, datë 8.5.2018, subjekti ka shitur motor, marka “P” për shumën 200,000 lekë. Pagesa provohet me *cash deposit* të datës 7.5.2018 në BKT. Ky motor është blerë në datën 29.11.2017 me faturën tatimore nr. \*\*\*, për shumën 147, 000 lekë. Pagesa provohet me kuponin tatimor të datës 29.11.2017.

Vitet	29.11.2017
<b>PASURITË</b>	<b>-578,425.47</b>
Motor “Piaggio”, ***	147,000.00
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-725,425.47</i>
<b>DETYRIME</b>	<b>-147,451.19</b>
Kredi bankare në BKT G.Hoxha	0.00
Pagesat e kredisë principal	-147,451.19
<b>PASURI NETO</b>	<b>-430,974.28</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>2,326,724.58</b>
Të ardhurat e Gerd Hoxha	1,205,965.75
Të ardhurat e E. Ll	1,120,758.83
<b>SHPENZIMET</b>	<b>1,842,554.24</b>
Shpenzimet jetike	872,864.86
Pagesat e interesave të kredisë në BKT	156,954.37
Shpenzime për pushime	438,735.00
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	374,000.00
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>915,144.63</b>

**29. Gjendje *cash***, të mbajtura në banesë, nga kursimet, ndër vite, nga paga e subjekti dhe e ish-bashkëshortes. Vlera 500.000 lekë, pjesa takuese 50%.

**29.1** Komisioni konstaton se kjo gjendje *cash* është deklaruar edhe në DVP/2016, për pasojë analiza financiare do të përqendrohet vetëm në këtë vit.

Vitet	Shtator - dhjetor 2016
<b>PASURITË</b>	<b>1,687,743.38</b>
Makinë “Toyota” TR ***T	676,350.00
<i>Shtesa / pakësime të likuiditeteve cash dhe banke</i>	<i>1,011,393.375</i>
CASH	500,000.00
<b>DETYRIME</b>	<b>-449,440.18</b>

<sup>32</sup> Shih shkresën e datës 7.7.2020 të noterit publik M.Ll.

Pagesat e principal të kredisë në BKT	-36,055.06
Detyrime të likuiduara për “Tirana Leasing”	-413,385.12
<b>PASURI NETO</b>	<b>2,137,183.56</b>
<b>TË ARDHURA ME DOKUMENTE</b>	<b>2,063,038.75</b>
Të ardhurat e subjektit 1995-2000	0.00
Të ardhurat e subjektit	353,859.25
Të ardhura të pagës E.LI	288,844.50
Të ardhura nga shitja e makinës tip “C C*” AA *** EO	1,420,335.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>528,705.48</b>
Shpenzimet jetike	235,092.00
Pagesat e interesave të kredisë BKT	43,613.48
Shpenzime për pushime brenda dhe jashtë vendit	250,000.00
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>-602,850.29</b>

**29.2** Nga analiza rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë gjendjen *cash* prej 500,000 lekë të deklaruar në deklaratën “Vetting”. Subjektit iu kalua barra e proveë në lidhje me këtë konstatim.

**29.3** Në parashtrimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se nëse nga ana e Komisionit do të përfshiheshin në analizë financiare të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme gjatë viteve 1995-2000, kursimet *cash* në shumën 1,200,000 lekë të përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2011, si dhe kursimet *cash*, sikundër janë deklaruar nga bashkëshortja e tij në deklaratat periodike ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Më në detaje shpjegimet e subjektit janë trajtuar në pikën 27.4.2.

**29.4.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke u mbështetur në analizën e kryer më lart, në lidhje me të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për periudhën 1995-2000, trajtuar në pikën 26.3.5 të këtij vendimi dhe të ardhurat nga shitja e automjetit dhe kursimet *cash* të bashkëshortes së tij trajtuar në pikën 27.4.3, vlerëson të përfshijë në analizë financiare këto të ardhura.

Vitet	Shtator - 29 dhjetor 2016
<b>PASURITË</b>	<b>1,307,913.32</b>
Makinë “Toyota” TR ***T	676,350.00
Pakësim likuiditete	631,563.32
<b>DETYRIME</b>	<b>-449,440.18</b>
Kredi bankare në BKT	0.00
Pagesat e principal të kredisë në BKT	-36,055.06
Detyrime të likuiduara për “Tirana Leasing”	-413,385.12
<b>PASURI NETO</b>	<b>1,757,353.50</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,063,038.75</b>
Të ardhurat e subjektit	353,859.25
Të ardhura të pagës E. LI	288,844.50
Të ardhura nga shitja e makinës, tip “C. C*” AA *** EO	1,420,335.00

<b>SHPENZIMET</b>	<b>278,705.48</b>
Shpenzimet jetike	235,092.00
Pagesat e interesave të kredisë BKT	43,613.48
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>26,979.77</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash*.

**30. Automjet tip “Audi”<sup>33</sup>**, me targë AA \*\*\*AP, në pronësi të babait të subjektit z. R. H, në përdorim nga subjekti, sipas kontratës së huapërdorjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.7.2011.

#### **Hetimi<sup>34</sup>/ analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni**

**30.1** Subjekti, në datën 7.7.2011, me kontratë huapërdorje nr. \*\*\* ka marrë në përdorim nga babai i tij z. R. H, automjetin “Audi”, tip “\*\*\* Q\*”. Kjo kontratë është e hartuar në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Ky automjet rezulton të jetë blerë nga babai i subjektit për shumën 37.000 USD dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 931,091 lekë.

Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit në “Tirana Bank” rezulton se:

- në datën 25.4.2011, z. R. H ka depozituar shumën 15.000 USD;
- në datën 25.4.2011 i është transferuar shuma 12.102 USD nga z. A.H me emërtim “borxh për blerjen e makinës”;
- Në datën 25.4.2011 i është transferuar shuma 10.000 USD nga znj. M. B me emërtim “borxh për blerje makine”.
- Në datën 25.4.2011 është transferuar shuma 37.000 USD në llogarinë e B dhe M.B.

**30.2** Komisioni i ka kërkuar informacion të detajuar subjektit në lidhje me mundësinë e babait të tij për blerjen e këtij automjeti. Në përgjigje të pyetësorit të datës 6.8.2020 subjekti ka sqaruar se: “Automjeti tip “Audi” me targë AA \*\*\*AP është blerë nga Z. R.H nga shitësi z.B. B, qytetar i SHBA, në shumën 37.000 USD. Detyrimet doganore, AUT, TVSH të paguara nga z.R. H janë në shumën 932.091,00 lekë.

*Shuma për blerjen e këtij automjeti është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga prindërit e tij z.R. H dhe znj.A. H ndër vite, që prej fillimit të marrëdhënieve të punës në vitin 1973 e deri ditën e blerjes së këtij automjeti.”*

Subjekti, për të vërtetuar të ardhurat e prindërve të tij, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

- aktverifikimi, datë 17.2.2009, mbajtur nga Drejtoria e Shëndetit Publik Tepelenë për llogaritjen e vlerës së pensionit në detyrën e “mjeke specialiste” të znj. A. H;
- vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare lëshuar nga DRSSH-ja Gjirokastër dhe Drejtoria e Shëndetit Publik Tepelenë për znj. A. H për periudhën 1.1.1994 – 20.8.1997;

<sup>33</sup> Subjekti ka dorëzuar kontratë huapërdorje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.7.2011.

<sup>34</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.02.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor; kthim përgjigjeje DPSHTRR nr. \*\*\* prot., datë 25.02.2019; Kthim përgjigjeje DPSHTRR nr. \*\*\* prot., datë 01.03.2019; Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 02.07.2020 drejtuar DPSHTRR; Kthim përgjigjeje DPSHTRR nr. \*\*\*\* prot., datë 07.07.2020; Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 21.02.2019 drejtuar Bankave; Kthim përgjigjeje Tirana Bank nr. \*\*\* prot., datë 08.03.2019.

- vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për znj. A.H, lëshuar nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, për periudhën 1998-2006;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.8.2020 i ISSH-së Drejtoria Rajonale Tiranë për të ardhurat totale të përfituara nga znj. A.H nga pensioni i pleqërisë periudha 25.11.2008 e në vijim;
- vërtetim nr. s'ka prot., datë 21.2.2014 “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni në detyrën e “inxhinierit të minierave”, lëshuar nga DRSSH-së Gjirokastër për z. R.H, ku figuron periudha e punësimit të tij si inxhinier miniere, që nga datë 15.8.1973 – 31.5.1997;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të z. R.H, për periudhën 1.1.1994 – 31.5.1997, lëshuar nga DRSSH-ja Gjirokastër;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të z. R.H, për periudhën 1.10.2010 – 31.12.2013, lëshuar nga “Prodhim Mobilje” sh.a., Tiranë;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të z. R. H, për periudhën 28.12.2005 – 31.12.2009, lëshuar nga “Prodhim Mobilje” sh.a., Tiranë;
- Vërtetim nr. \*\*\*prot, datë 11.8.2020, lëshuar nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Tiranë për të ardhurat totale të përfituara nga z. R.H nga pensioni i pleqërisë për periudhën 16.12.2000-30.01.2006<sup>35</sup> dhe 1.1.2014 e në vijim;
- vërtetim për të ardhura neto të fituara nga puna e z. R. H- si anëtar i Këshillit Bashkiak në Njësinë Bashkiake nr. \*, Tiranë, për periudhën korrik 2011 – korrik 2015, lëshuar nga kjo Njësi;
- deklaratë noteriale nr.\*\*\*, datë 11.6.2018 lëshuar nga z.M.S, që deklaroi se, z. R.H ka ushtruar profesionin e taksistit me automjetin “Benz \*\*\*” me targa TR \*\*\* D, të palicencuar, në periudhën nga viti 1998 – 2005. Xhiroja ditore varionte nga 2 500 lekë –3 500 lekë;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.6.2018, lëshuar nga z. R.H, që deklaroi se, ai ka ushtruar profesionin e taksistit, të palicencuar, në periudhën nga viti 1998 – 2005, me automjetin “Benz \*\*\*” me targa TR \*\*\* D.
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.6.2018 lëshuar nga z.A. M, që deklaroi se, z.R. H ka ushtruar profesionin e taksistit, të palicencuar, në periudhën nga viti 1998 – 2005;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.6.2018, lëshuar nga z. D.P, që deklaroi se z.R.H ka ushtruar profesionin e taksistit, të palicencuar, në periudhën nga viti 1998 – 2005;
- deklaratë noteriale nr.\*\*\*, datë 8.6.2018, lëshuar nga z.Y. D, që deklaroi se z. R.H ka ushtruar profesionin e taksistit, të palicencuar, në periudhën nga viti 1998 – 2005.

Në përgjigje të pyetësorit të datës 5.2.2021 subjekti ka sqaruar se:

*“Ky automjet është blerë nga baba i tij, për shkak të kondicioneve të tij të veçanta fizike. Ky automjet ka qenë në pronësi të babait të tij dhe është përdorur prej tij për një periudhë 7-vjeçare deri në vitin 2018 kur gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua dhe i ati e shiti këtë automjet. Të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në vitin 2018, kanë mbetur të depozituara në llogarinë e tij personale bankare.*

*Automjeti nuk ka qenë asnjëherë në pronësinë e subjektit dhe qëllimi i blerjes nuk ka qenë përdorimi nga të tretë, anëtarë të tjerë të familjes, apo dhe ai vetë. Kjo provohet lehtësisht edhe nga fakti që ai dhe ish-bashkëshortja kanë blerë nëpërmjet leasingut financiar pothuaj një vit më vonë, më datë 16.08.2012 automjetin tonë “C.C\*”, targuar AA \*\*\* EO, i deklaruar në mënyrë të rregullt në deklaratimet periodike vjetore, dhe vetë formularin Vetting.*

*Përdorimi nga ana e tij ka qenë sporadik vetëm për udhëtime jashtë shtetit (pak herë në vit) dhe jo për përdorim të përditshëm. Në asnjë rresht të deklaratimeve të tij nuk ka thënë se, automjeti tip “Audi” me targë AA\*\*\*AP është në përdorimin të tij të përditshëm. Sipas të gjitha deklaratimeve para ILDKPKI dhe në deklaratën “Vetting” dorëzuar më 25.1.2017 të bëra nga ai dhe ish-bashkëshortja e tij znj.E.LI lidhur me përdorimin e këtij automjeti sipas kontratës së huapërdorjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol, dt.7.7.2011 rezultoi se, ky automjet është përdorur nga ata vetëm për udhëtimet jashtë shtetit. Përdorimi i automjetit jashtë shtetit kërkonte patjetër një “autorizim” nga pronari apo kontratë huapërdorjeje, përndryshe nuk mund të kaloje*

<sup>35</sup> Trajtuar me pension minatori.



*kufirin shtetëror. Arsyeja e përdorimit jashtë shtetit ka qene se, automjeti ishte më i sigurt nga pikëpamja teknike dhe ne në atë kohë nuk dispononte automjet Automjeti “C” ka qenë i vetmi mjet gjatë kësaj periudhe që përdorej prej tij rregullisht mbi baza ditore....”*

**30.3** Nga të dhënat e AMF-së rezulton se subjekti është policëmbajtës i policave të sigurimit për këtë mjet për periudhat:

30.7.2016-29.7.2017<sup>36</sup>; 30.7.2015 - 29.7.2016<sup>37</sup>; 27.7.2013 - 25.7.2014<sup>38</sup>; 4.7.2012-3.7.2013<sup>39</sup>; 1.7.2011 - 30.6.2012<sup>40</sup>; 9.3.2018 - 23.3.2018; 10.2.2017 - 24.2.2017; 25.11.2016-9.12.2016; 24.8.2016-7.9.2016; 11.3.2016-25.3.2016; 30.12.2015 -13.1.2016<sup>41</sup>; 27.11.2015-11.12.2015<sup>42</sup>; 21.8.2015-4.9.2015;18.1.2013-18.1.2014<sup>43</sup>;19.10.2012-18.01.2013<sup>44</sup>; 8.9.2012-22.9.2012<sup>45</sup>; 7.4.2012-21.4.2012;16.1.2012-30.1.2012;25.11.2011-9.12.2011<sup>46</sup>;26.8.2011-5.10.2011<sup>47</sup>; 8.7.2011-22.7.2011<sup>48</sup>.

Ndërkohë ish-bashkëshortja e subjektit, përveç sa më lart, rezulton si policëmbajtëse e policës të sigurimit për këtë mjet dhe për periudhën 30.7.2017-29.7.2018.

**30.4** Automjeti tip “Audi” është shitur në datën 28.7.2018 nga babai i subjektit me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 15.000 euro.

**30.5** Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me babain e subjektit për të analizuar mundësitë financiare të tij për blerjen e automjetit.

Nga hetimi ka rezultuar se:

- i. babai i subjektit ka blerë apartament me kontratën nr.\*\*\*\*, në datën 30.5.1997 për shumën 1,250,000 lekë;
- ii. babai i subjektit ka ndërtuar<sup>49</sup> një objekt (shtesë banese) në faqen anësore të pallatit ku ndodhet apartamenti i tij. Sipas planimetrisë së gjendur në dosjen e ALUIZNIT sipërfaqja e ndërtimit është 26.77 m<sup>2</sup>.

Në datën 3.5.2013 është lidhur kontrata për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, nëpërmjet së cilës babai i subjektit ka blerë sipërfaqen ndërtimore prej 26.77 m<sup>2</sup> të shtesës. Çmimi i blerjes bazuar në kontratën e mësipërme është taksa e ndikimit në infrastrukturë 4003 lekë dhe parcela ndërtimore 53 540 lekë. Në datën 6.5.2013 është lëshuar leja e legalizimit për këtë pasuri, e cila më pas është regjistruar në ASHK-në Tiranë me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*.

Në lidhje me këtë shtesë, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 5.2.2021 ka sqaruar se...*Familja e tij jetonte në një apartament, të përfituar nga baba i tij, nëpërmjet privatizimit, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.11.1994. Babai e shiti apartamentin e tij në Memaliaj me kontratën noteriale nr. \*\*\*Rep, nr. \*\* Kol, datë 22.5.1997, në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë.*

<sup>36</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>37</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>38</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>39</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>40</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>41</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>42</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>43</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>44</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>45</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>46</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>47</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>48</sup> Së bashku me ish bashkëshorten.

<sup>49</sup> Shih shkresën nr.\*\*\*\* prot.,datë 24.8.2020.

*Pak ditë më vonë familja është zhvendosur në Tiranë, në lagjen nr. \*\*, rr. "H.C", p.\*\*, shk. \*, ap. 67 me sipërfaqe 54 metër katror. Blerja e këtij apartamenti është bërë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.1997, me çmimin prej 1,250,000 lekë. Në momentin e blerjes apartamenti kishte edhe një shtesë prej 13 metër katror, e cila ishte bërë nga ish-pronari, dhe kjo shtesë nuk ishte deklaruar apo regjistruar më parë.*

*...Rreth vitit 1999 deri më vitin 2001, babai i tij ka ndërtuar për nevoja banimi një shtesë anësore, në vijim të shtesës prej 13 metër katror të bërë nga ish-pronari...*

*Sa më sipër, provohet lehtësisht edhe nga dokumenti "Vetëdeklarim" i përpiluar nga babai i tij z.R. H i bërë pranë Njesisë Bashkiake nr. \*, Tiranë, me nr.\*\*\* prot., datë 14.11.2006 për efekt legalizimi, nga ku rezulton se, shtesa anësore e bërë nga babai është deklaruar saktësisht që në atë kohë, me sipërfaqe 14 (katërmbëdhjetë) m<sup>2</sup> e përfunduar. Ndërkohë që, e gjithë shtesa pa leje ka një sipërfaqe prej 26,77 (njëzet e gjashtë presje shtatëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, ku përfshihet edhe ndërtimi i bërë më parë nga ish-pronarët. Për efekt të ligjit, është legalizuar gjithë shtesa prej 26,77m<sup>2</sup>, si pjesë e përbërë e apartamentit në fjalë...*

*Gjatë kohës së ngritjes së kësaj shtese ai ka qenë student.*

*Në funksion të një përgjigjeje të saktë dhe shteruese, pavarësisht se kjo shtesë është ngritur nga babai, tërësisht me kontributin e tij, babai ka kërkuar shërbimet e një eksperti të pavarur për të inspektuar ndërtimin e shtesës dhe për të përgatitur një raport të pavarur, në lidhje me këtë shtesë, i cili gjendet bashkëlidhur përgjigjeve.*

*Sipas raportit rezulton se kjo shtesë nuk ka themele e mbushje me xoklaturë, nuk ka kolona e trarë betonarme, nuk janë ndërtuar të gjithë muret por 65% e tyre, pjesa e ndërtuar nga babai është me çati me kapriate të pjerrët, mbështetur në murin anësor, nuk ka punime hidraulike, nuk është ndërtuar nga një shoqëri ndërtimi, çka e zhvesh vlerën e saj nga masa e fitimit dhe TVSH-ja.... Vlera e investimit e përlllogaritur nga eksperti është 339 710 (treqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë."*

**Subjekti ka depozituar:**

- kontratë shitjeje nr. \*\*, datë 22.5.1997 nëpërmjet së cilës prindërit e tij së bashku me z. H. A (vëllai i nënës së subjektit) kanë shitur apartament në qytetin e Tepelenës për shumën 1,000,000 lekë;
- vetëdeklarim për legalizimin e shtesës datë 14.11.2006 të babait të tij. Në këtë vetëdeklarim z. R.H ka deklaruar shtesë banese anësore me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup>;
- raport vlerësim investimi përgatitur nga një ekspert i vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Sipas këtij raporti vlera e shtesës prej 14.77 m<sup>2</sup> është 339,710 lekë.

**30.6** Në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A. H dhe znj. M. B subjekti deklaron se ai personalisht nuk ka patur marrëdhënie me z. A. H apo me znj.M.B. I ka njohur nga i ati. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të z. A. H dhe znj.M.B, si dhe njohja me babain e tij z. R. H është sqaruar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2020.

Me deklaratën noteriale nr. \*\*\*\*, datë 14.08.2020, shtetasit A.H dhe M. B deklarojnë se z. H ka qenë i punësuar pranë "T. B" sh.a. që prej vitit 1997 dhe ortak e administrator i fimirës "A. I" sh.p.k nga viti 2006.

Znj. B është ortakë dhe administratore e shoqërisë "K. H & E" sh.p.k nga viti 2008 gjithashtu ushtron dhe profesionin e dentistes në klinikën "P. D.

Të dy bashkëjetojnë që nga viti 1995 dhe kanë dy fëmijë...

Në prill të vitit 2011 z. R. H i ka kërkuar hua shumën 22,000 USD për një afat 1-mujor, për të blerë një makinë në USA....Brenda afatit të kërkuar z. R. H e ktheu shumën që i detyrohej cash dhe ata i lëshuan deklaratë personale për likuidimin e detyrimit...

Ai dhe znj. M për arsye të ardhurave nga rrogat, aktivitetet tregtare por dhe të ardhurave nga qiratë e pronave të familjeve të tyre kishin kursime të mjaftueshme për të mundësuar fondet që i dhanë hua z. R.H."

Subjekti përveç deklaratës noteriale të mësipërme ka depozituar:

- i. deklaram me shkrim dore të z. A. H të datës 10.5.2011, në të cilin ai deklaron se z. R.H i ka likuiduar borxhin që i kishte dhënë në datën 10.05.2011 në shumën 12.102 USD;
- ii. deklaram me shkrim dore të znj. M. B të datës 14.05.2011 në të cilin ajo deklaron se z. R. H i ka likuiduar borxhin që i kishte dhënë në datën 25.4.2011 në shumën 10.000 USD;
- iii. deklaratë noteriale të z. E. L, i cili deklaron se *në vitin 2011 i ka marrë z. R. H shumën prej 22 000 USD, për t'i blerë një automjet, të cilin më pas z. H e bleu vetë në SHBA. Këtë shumë ia ka kthyer z. H në muajin maj 2011. Për shkak të marrëdhënies së miqësisë mes tyre, nuk kanë përpiluar asnjë dokument për të vërtetuar këtë marrëdhënie.*

Në përgjigje të pyetësorit të datës 5.2.2021, subjekti, në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të huadhënësve, ka depozituar:

- i. vërtetim, datë 11.2.2021, "T- B", që provon se z. H ka marrë në formë page për periudhën 2005-2011 shumën prej 16,801,768.00 lekësh.
- ii. ekstrakt i shoqërisë "A.I" sh.p.k., me ortak z. A. H dhe z. S. O dhe pasqyrën e plotë financiare për vitin 2011 dhe shënimet shpjeguese së bashku me paqyrat e analizave dhe shpenzimeve të vitit 2010 të kësaj shoqërie.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare rezulton se kjo shoqëri për vitin 2010 dhe 2011 nuk ka shpërndarë dividend, për rrjedhojë fitimi i kësaj shoqërie nuk mund të përfshihet në analizën financiare të z. A. H.

- iii. ekstrakt i shoqërisë "K. H & E" sh.p.k., me ortak të vetëm znj. M.B dhe pasqyrat financiare për vitet 2010 dhe 2011 të kësaj shoqërie, depozituar pranë organeve tatimore.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare rezulton se kjo shoqëri ka shpërndarë dividend në vitin 2009 shumën 9,517,661 lekë dhe në vitin 2010 shumën 13,137,443 lekë.

**30.6.1** Nga hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e z. H dhe znj. B rezulton se:

- i. DPT përmes shkresës nr \*\*\* datë 03.02.2021 nga të dhënat në sistemin informatik tatimor C@TS, datë 2.2.2021 informon se:
  - A.H rezulton të jetë administrator i subjektit "A. I" dhe aksioner nga data 7.10.2015 me Nipt J\*\*\*E me status "aktiv" që në datën 28.2.2006.
  - A.H rezulton të jetë administrator i subjektit "T" dhe aksioner nga data 13.2.2018 me Nipt K\*\*\*I me status "aktiv" që në datën 13.2.2018.
  - M.M. B rezulton të jetë administrator i subjektit "K. H& E" dhe aksioner nga data 7.10.2015 me Nipt J\*\*\*E me status "aktiv" që në datën 28.2.2006.
  - M.B rezulton të jetë administrator i subjektit "R. C " dhe aksioner nga data 7.10.2015 me Nipt K\*\*\*O me status "pasiv" që në datën 6.5.2016.
- ii. Nga ekstrakti historik i punonjësit vënë në dispozicion nga DPT-ja rezultojnë të dhëna se z. A. H ka përfituar të ardhura mujore si më poshtë :
  - për vitin 2001 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 200,943 lekë;
  - për vitin 2002 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2003 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2004 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2005 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 255,625 lekë;
  - për vitin 2006 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2007 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 255,625 lekë;
  - për vitin 2008 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2009 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2010 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;
  - për vitin 2011 pagë bruto nga Banka e Tiranës vlerën 204,500 lekë;

- për vitin 2001 deri më 2012 pagë bruto nga “A. I” vlerën 80,000 lekë

Për të ardhurat janë derdhur të gjitha detyrimet ligjore (Kontributet e punëdhënësit, kontribute të punëmarrësit, kontribute shoqërore dhe shëndetësore) përkatëse.

- iii. Nga të dhënat e nxjerra nga sistemin informatik tatimor, për subjektin “K.H& E”, rezultojnë se :
  - fitimi i deklaruar mbi të cilin është llogaritur tatim fitimi në datë 27.3.2009 është 10,575,179 lekë;
  - fitimi i deklaruar mbi të cilin është llogaritur tatim fitimi në dt.28.3.2011 është 23,658,918 lekë.
- iv. Nga të dhënat e nxjerra nga sistemin informatik tatimor, për subjektin “R. C” rezultojnë që fitimi i deklaruar për vitet 2009-2010-2011 është 0 (zero) lekë.
- v. Nga ekstrakti historik i punonjësit rezultojnë të dhëna se zj.M.B ka përfituar për vitin 2001-2012 të ardhura mujore në vlerën 26,000 lekë, për të cilat janë derdhur të gjitha detyrimet ligjore (Kontributet e punëdhënësit, kontribute të punëmarrësit, kontribute shoqërore dhe shëndetësore) përkatëse.

Komisioni ka kryer dhe një hetim të plotë në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të z. H dhe znj. B, të cilat janë përfshirë si shpenzime në analizën e mëposhtme financiare.

### 30.6.2 Analiza financiare

	<b>TOTAL 2001-2011</b>
Fitimi i deklaruar “K. H&E”	34,234,097.00
Të ardhurat nga paga A. H	38,738,316.00
Të ardhurat nga paga M. B	3,432,000.00
<b>Totali i të ardhurave (I)</b>	<b>76,404,413.00</b>
Shpenzime jetike (4 Persona)	5,168,144.00
Blerje pasurie të paluajtshme	6,163,164.00
Makina “BMW AG” blerë në 2003	250,000.00
Makina “C. GCB” blerë në 2008	500,000.00
<b>Totali i shpenzimeve (II)</b>	<b>12,081,308.00</b>
<b>Të ardhura neto (I-II)</b>	<b>64,323,105.00</b>
Mundësia për kursime	64,323,105.00

Nga analiza financiare rezultojnë se z. A. H dhe znj. M.B kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënie të huasë z. R. H.

### 30.6 Analizë financiare për blerjen e automjetit

<b>Vitet</b>	<b>Rezultat kumulativ</b>
<b>PASURITË</b>	<b>5,635,480.45</b>
Apartament sip 54 m <sup>2</sup> në pronësi të prindërve R. dhe A.H blerë në vitin 1997	1,250,000.00
Shtesa prej 26.77 m <sup>2</sup> bërë në vitin 1999-2001	497,520.45 <sup>50</sup>
Makinë “Audi” në përdorim/pronësi të R. H	3,887,960.00
Shtesa / pakesime të likuiditeteve cash dhe bankeë	0.00
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>5,635,480.45</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>13,931,181.17</b>
Të ardhurat e subjektit <sup>51</sup>	4,408,502.00
Të ardhurat e R. H	5,247,338.33
Të ardhurat e A. H	3,212,976.83

<sup>50</sup> Llogaritur sipas vendimit nr. \*\*\* të KPA-së.

<sup>51</sup> Nga të ardhurat në total të subjektit në shumën 7 924 225 lekë janë zbritur të vlerat e deklaruara si kursim cash nga subjekti në DVP-në përkatëse.

Të ardhurat A. A, vdekur në 2003	62,364.00
Të ardhura I.H (K)	0.00
Të ardhura P. H	0.00
Të ardhura nga shitja e pasurive	1,000,000.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>8,975,848.86</b>
Shpenzimet jetike	6,428,934.76
Shpenzime pagese taksë zhdoganimi	931,091.00
Udhëtimi jashtë vendit	1,615,823.10
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>-680,148.14</b>

Në analizën financiare janë reflektuar pagat e prindërve të dokumentuara, pagat e subjektit pas zbritjes së kursimeve të deklaruara prej tij ndër vite, si dhe paga e z. A. A, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2003.

Për periudhën 1994-2000 janë konsideruar shpenzime jetike 66% e të ardhurave të dokumentuara nga paga e pjesëtarëve të familjes.

**30.7** Nga analiza duket se babai i subjektit nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë këtë pasuri në vlerën 680,148.14 lekë.

**30.7.1** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se nga observimi i analizës së Komisionit dhe tabelës përkatëse në lidhje me të ardhurat e familjes së babait të tij, ka vënë re se në të mungojnë të ardhurat e motrave të tij I. H, dhe P.H (P), të ardhurat dhe burimi i të cilave i është vënë në dispozicion Komisionit, së bashku me evidencat e vërtetimeve dhe/ose dëshmime të pagesave të tatimeve dhe kontributeve përkatëse.

Konkretisht, në tabelën dhe analizën e Komisionit mungojnë dhe nuk janë përfshirë të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të motrës së tij I. H për periudhën 2006 – dhjetor 2010, periudhë, në të cilën ajo ka qenë pjesë e trungut familjar, në shumën prej 2,079,124 lekë dhe po ashtu në të nuk janë përfshirë shpenzimet e jetesës për vitet 2008-2010, nga të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të motrës së tij P. H (P) në shumën prej 409,860 lekë, shpenzime për më tepër këto të konstatuara dhe njohura nga vetë analiza e Komisionit, për sa kohë ajo ka qenë subjekt i rivlerësimit<sup>52</sup> dhe pjesë e trungut familjar të familjes së babait të tij.

Vlera totale e të ardhurave dhe shpenzimeve të jetesës nga të ardhura të ligjshme të pallogaritura në tabelën përkatëse është 2,488,984 lekë, vlerë e cila përmbys qartësisht balancën negative prej 680,148.14 lekësh dhe sjell një balancë pozitive prej 1,808,835.86 lekësh.

Subjekti kërkoi nga Komisioni që të përlllogarisë vlerën shtesë të të ardhurave të anëtarëve të trungut familjar të babait të tij në tabelën e analizës financiare.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit certifikatë familjare të z. R.H, nga ku rezulton se në përbërjen e familjes së tij deri në vitin 2010 ka qenë znj. I. H dhe deri në vitin 2012 ka qenë znj. P. H.

**30.7.2** Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse. Nga verifikimi i vendimit nr. 308, datë 14.10.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket motrës së subjektit P. P, rezulton se ajo ka deklaruar si kursime *cash* para detyrës shumën 700,000 lekë. Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare të z. R.H shpenzimet jetike të znj. P për periudhën që ajo ka qenë e punësuar për sa kohë provohet që ajo ka krijuar të ardhura personale<sup>53</sup>, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se znj. P. P ka patur kursime *cash* shumën 700,000 lekë, ndërkohë shuma tjetër që ajo ka përfituar nga punësimi rrjedhimisht ka shërbyer për të mbuluar shpenzimet jetike, të cilat i janë llogaritur në analizën e z. R. H.

<sup>52</sup> Referohuni faqes 25 të vendimit nr. 308, nr. 180 akti, datë 14.10.2020, të Komisionit.

<sup>53</sup> I njëjti qëndrim është mbajtur nga Komisioni dhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 23.3.2021 për subjektin A.Ç.

Komisioni do të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e znj. I. H deri në vitin 2010 kur ajo është larguar nga trangu familjar.

### 30.7.3 Analizë financiare

Vitet	Rezultat kumulativ
<b>PASURITË</b>	<b>5,602,785.11</b>
Apartament sip. 54 m <sup>2</sup> në pronësi të prindërve R dhe A. H	1,250,000.00
Shtesa prej 26.77 m <sup>2</sup>	497,520.45
Makine “Audi” në përdorim/pronësi të R. H	3,887,960.00
Shtesa /pakësime të likuiditeteve <i>cash</i> dhe banke	-32,695.34
<b>DETYRIME</b>	<b>0.00</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>5,602,785.11</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>15,770,381.17</b>
Të ardhurat e subjektit që kanë shërbyer si burim për blerje të makinës “Audi”	4,408,502.00
Të ardhurat e R. H	5,247,338.33
Të ardhurat e A. H	3,212,976.83
Të ardhurat A. A, vdekur në 2003	62,364.00
Të ardhurat I. H (K) - larguar në 2010	1,839,200.00
Të ardhurat P. H - larguar në 2012	0.00
Të ardhura nga shitja e pasurive	1,000,000.00
<b>SHPENZIMET</b>	<b>8,678,363.86</b>
Shpenzimet jetike	6,131,449.76
Shpenzime pagese taksë zhdoganimi	931,091.00
Udhëtimi jashtë vendit	1,615,823.10
<b>REZULTATI FINANCIAR ME TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>1,489,232.20</b>

Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin që kjo analizë i përket babait të subjektit, i cili, si ai, ashtu edhe familjarët e tij, nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrimin e deklarimit të të ardhurave, si dhe faktit që në mungesë të të dhënave të plota ka qenë objektivisht e pamundur për të kryer një analizë të saktë dhe të mirëfilltë të gjendjes së tyre financiare<sup>54</sup>.

Gjithashtu, Komisioni i referohet dhe vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të KPA-së, i cili orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, sipas paragrafit 2 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, si vijon: “Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur”.

**30.8** Në datën 28.3.2014 subjekti ka derdhur shumën prej 254,170 lekësh në llogari të “P- A” sh.p.k., me përshkrimin “Gerd Hoxha derdh në llogari të “P-A” sh.p.k. shërbime për makinë – automjet për R. H”. Në lidhje me këtë konsatim subjekti sqaron se *pagesa nga ana e tij është bërë për lehtësi veprimi, në kuadrin e marrëdhënies babë- bir. Shuma e parave të paguara nga ai i është dhënë nga babai, z.R. H, për t’i derdhur në llogarinë e “P- A”, për likudimin e një tarife shërbimesh për makinën e tij me targë AA\*\*\*AP. Ky fakt është shënuar nga ai gjatë kryerjes së këtij veprimi.*

<sup>54</sup> I njëjti qëndrim është mbajtur nga Komisioni dhe në vendimin nr.\*\*\*, datë 23.3.2021 për subjektin A.Ç.

**31. Llogari bankare**<sup>55</sup> në emër të subjektit, në bankën BKT, Tiranë, ku u depozitua shuma e çmimit të shitjes së automjetit tip “C. C\*”, me targë AA \*\*\* EO. Shuma është në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten znj. E. Ll. Vlera 4.003,5 euro, pjesa takuese 50%.

#### **Hetimi**<sup>56</sup>/ analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni

Në datën 10.11.2016, me kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\* subjekti ka shitur automjetin tip “C. C\*”, për çmimin 10.500 euro. Pagesa konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë në monedhën euro në bankën BKT, në emër të subjektit, në të cilën rezulton se në datën 15.11.2016 është transferuar shuma 10.489,5 euro, nga personi fizik “R. S”, për pagesë makine. Një pjesë e kësaj shume është përdorur për blerjen e automjetit tip “T. R \*”, ndërsa pjesa e mbetur ka ngelur në llogarinë bankare.

Nga hetimi nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime.

### **DETYRIME FINANCIARE**

**32. Hua pa interes**<sup>57</sup> dhe pa afat. Shuma e detyrimit e mbetur pa shlyer 25.000 euro.

#### **Hetimi**<sup>58</sup>/ analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni

**32.1** Subjekti, tek të dhënat konfidenciale, në lidhje me huan, sqaron hua pa interes dhe pa afat në shumën 25.000 euro, marrë në vitin 2011 prej ish-bashkëshortes së tij znj. E. Ll nga prindërit e saj, shumë e cila shërbeu për shlyerjen e kredisë së marrë më 2.4.2009, në Bankën “Emporiki Bank”, kredi e cila u shlye tërësisht në këtë bankë, më 2.2.2011. Nuk ka kontratë për shkak të marrëdhënies së posaçme mes palëve.”

**32.2** Nga hetimi ka rezultuar se:

i. Në datën 26.3.2009 bashkëshortja e subjektit, me kontratë huaje nr. \*\*\*, ka marrë kredi në shumën 25.000 euro.

Dorëzanës në këtë kredi ka qenë subjekti i rivlerësimit dhe znj. A. Ç. Bazuar në pikën 2 të kontratës, kjo hua do të përdoret për rikonstruksion apartamenti. Referuar nenit 14 të kësaj kontrate apartamenti që do të rikonstruktohet është apartamenti që ka në pronësi aktualisht subjekti.

ii. Në dosjen e kredisë gjendet deklaratë noteriale nr. \*\*\* datë 26.02.2009 në të cilën znj. A. Ç dhe z. A.Ç deklarojnë se marrin përsipër që pasurinë apartament, me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup> t’ua kalojnë në pronësi shtetasve E. Ll dhe Gerd Hoxha brenda një periudhe një vjeçare nga hartimi i deklaratës.

iii. Si garanci për këtë kredi<sup>59</sup> është vendosur apartamenti i blerë nga subjekti me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup>.

Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit rezulton se:

- në datën 2.4.2009 është tërhequr shuma 15.000 euro;
- në datën 6.4.2009 është tërhequr shuma 9.000 euro;
- subjekti ka paguar disa këste kredie;

<sup>55</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim nr. extra prot., datë 20.1.2017, nga BKT; (ii) nxjerrje e llogarisë në monedhën euro në bankën BKT në emër të shtetasit Gerd Hoxha; (iii) kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.11.2016.

<sup>56</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019 drejtuar Bankave; kthim përgjigjeje BKT-ja nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019.

<sup>57</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim nga banka “Emporiki” me nr. \*\*-OS-\*\*\*, datë 1.3.2010; (ii) letër sqaruese e shtetasve Gerd Hoxha dhe E. Ll, drejtuar ILDKPKI-së datë 6.2.2015;

<sup>58</sup> Hetimi i Komisionit: shkresë nr.\*\*\* prot., datë 21.02.2019, drejtuar Bankave; Kthim përgjigjeje “Abi Bank” nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2019; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2020, drejtuar ABI Bank; kthim përgjigjeje Abi Bank nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

<sup>59</sup> Kontratë hipoteke nr.\*\*\*, datë 26.3.2009.

- në datën 2.2.2011 është depozituar shuma 24.500 euro nga ana e znj. A. Ç, e cila ka shërbyer për shlyerjen e plotë të kredisë.

Në lidhje me këtë hua subjekti<sup>60</sup> sqaron se:

*“Bazuar në kontratën e huasë dt.02.04.2009, shuma prej 25 000 euro është marrë hua vetëm nga ish-bashkëshortja e tij, nga “Emporiki Bank” Tiranë, me qëllim rikonstruksionin dhe arredimin e apartamentit në rr.”Sami Frashëri”, Tiranë, i cili u ble më pas nga ai dhe ish-bashkëshortja. Në këtë kontratë ai ka qenë në cilësinë e dorëzanësit.”*

- iv. Në deklaratën e datës 20.01.2015 pranë ILDKPKI-së subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar:

“Kredia prej 25, 000 (njëzetepesëmijë) euro, e marrë nga znj. E. Ll tek “Emporiki Bank”, ku ai ka qenë dorëzanës, është marrë për të rikonstruktuar dhe arreduar apartamentin. Kjo shumë e marrë kredi është përdorur për më shumë se një vit, deri në momentin e hyrjes në apartament në fillim - vitin 2011. Apartamenti në fjalë ishte në pronësi të znj. A.Ll, motra e znj. E.Ll. Por, familja e znj. A.Ll (Ç) nuk banonte aty, apartamenti ishte pothuajse i boshatisur dhe me mobilje të përdorura. Znj. A.Ll dhe z.A,Ç, nisur nga marrëdhënia e posaçme që kishin me të dhe znj. Ll, i kishin premtuar t’ia jepnin për banim këtë apartament. Për pasojë, ai dhe znj. E. Ll, menduan ta blinin, me qëllim që të banonin tek ky apartament, i cili fillimisht duhej të rikonstruktohej dhe riarredohet. Gjatë periudhës së arredimit dhe rikonstruktimit, ata nuk banonin në këtë apartament. Ai banonte tek prindërit e tij dhe znj. E.Ll tek prindërit e saj. Shuma prej 25, 000 (njëzet e pesë mijë) euro, që i është dhuruar znj. E. Ll nga babai i saj z. Xh.Ll është dhënë *cash*, pa ndonjë akt të shkruar për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë. Kjo shumë është siguruar nga z. Xh.Ll dhe znj. L.Ll nga kursimet e tyre familjare ndër vite dhe mbahej prej tyre në banesë në formë *cash*.”

Në këtë deklaratë subjekti dhe ish-bashkëshortja e tij deklarojnë se shuma 25.000 euro u është dhuruar, ndërkohë në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se shuma është marrë hua. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit të datës 6.8.2020 ai sqaron se gabimisht në procesverbalin e ILDKPI-së është shënuar se, shuma prej 25 000 euro i është dhuruar znj. E. Ll nga babai i saj z. Xh.Ll. Ndërkohë që, kjo shumë i është dhënë në formën e huas pa interes dhe pa afat, sikundër është pasqyruar nga ai dhe ish-bashkëshortja në të gjitha deklaratat vjetore të interesave pasurore të dorëzuara pranë ILDKPKI, si dhe në deklaratën “Vetting”, dorëzuar më 25.1.2017.

**32.3** Në DVP/2011 znj. E.Ll ka deklaruar se ka marrë hua shumën 25.000 euro nga prindërit e saj për shlyerjen e kësaj kredie.

Në lidhje me burimin e huasë subjekti deklaroi se ai përbëhet nga kursimet familjare të prindërve të znj. Ll.

Me deklaratë noteriale<sup>61</sup> nr. \*\*\*, datë 26.06.2018, prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit kanë deklaruar se: “...Sa i përket shumës 25.000 euro, të cilën ia kanë dhënë hua vajzës së tyre, ajo përfaqëson kursimet si familje nga momenti i hyrjes në punë deri në momentin e dhënies së kësaj huaje. Këto kursime përbëhen nga:

- i. pagat;
- ii. pensioni mujor i z. Xh. Ll nga viti 1994 e në vijim 28.300 lekë;
- iii. pensioni mujor i znj. L.Ll nga viti 2000 e në vijim 13.500 lekë;
- iv. shuma prej 40.000 lekë/muaj dhënë nga vajza A. Ç që prej vitit 1995 dhe aktualisht me qëllim përmbushjen e nevojave të tyre për jetesë mesatare dhe për çdo shpenzim tjetër, që kanë patur nevojë;
- v. disponojnë aktualisht shumën 1,500,000 lekë në BKT dhe 9.000 euro në BKT.”

<sup>60</sup> Shih pyetësorin e datës 6.8.2020.

<sup>61</sup> Shih shkresën datë 7.7.2020 të noterit publik M. Ll.



Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar, konstatoi se nuk ka ndonjë dokument shkresor, që të provojë ndihmën prej 40 000 lekë/muaj të dhëna z./znj Ll nga vajza e tyre A.Ç, pavarësisht se aftësitë financiare të znj. Ç e mundësojnë dhënien e një ndihme të tillë. Në këto kushte, Komisioni nuk i ka përfshirë këto shuma në analizën financiare.

	Rezultati Kumulativ 1995-2011
<b>Likuiditete në bankë</b>	<b>7,880,390.42</b>
Të ardhura nga pensionet	8,611,396.00
Të ardhura nga A. Ç	0.00
<b>Total i të ardhurave</b>	<b>8,611,396.00</b>
Shpenzime jetike	5,800,806.00
<b>Të ardhura neto</b>	<b>2,810,590.00</b>
<b>Mundësia për të kursyer</b>	<b>-5,069,800.42</b>

**32.4** Nga analiza financiare rezulton se prindërit e ish-bashkëshortes nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 25.000 euro znj. E. Ll në vitin 2011. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë rezultat të hetimit.

**32.5** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se lidhja e familjes Ç dhe prindërve të ish-bashkëshortes ka qenë një lidhje mjaft e ngushtë familjare. Me aq sa ai ka dijeni, familja Ç ka ndihmuar dhe kontribuar në vazhdimësi për familjen e prindërve të ish-bashkëshortes, pjesë e së cilës para martesës ka qenë edhe vetë ish-bashkëshortja e tij, dhe në dijeninë e tij, i ka mbështetur ata edhe me të ardhura / pension të rregullt, megjithatë ai nuk mund të japë një shpjegim më të detajuar, pasi kjo ka qenë një marrëdhënie private mes tyre. Subjekti kërkon që të merret në konsideratë fakti, që kjo hua është marrë përpara martesës së tij, për shlyerjen e një kredie, të cilën nuk e kam marrë ai. Gjithashtu ai nuk është në gjendje të japë shpjegime më të detajuara për një marrëdhënie prind-fëmijë, ku ai nuk ka qenë palë.

Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka sqaruar më tej se për shkak të situatës së vështirë të krijuar nga divorci dhe mungesa e komunikimit, ka qenë e vështirë dhe thujse e pamundur që ai të mbledhë dhe të sjellë informacion apo prova më të detajuara për persona të tretë të lidhur me ish-bashkëshorten e tij. Duke pasur parasysh që ngjarja i referohet një periudhë në të cilën ai nuk ka qenë i martuar si dhe duke qenë se aktualisht ai është në pamundësi reale për të marrë informacion më të detajuar, ai kërkon që këto fakte të merren në konsideratë nga Komisioni. Subjekti deklaron se bazuar dhe në vetë provat e administruar nga Komisioni, familja Ç ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 40,000 lekë prindërve të bashkëshortes. Kjo shumë është përdorur për jetesë nga ana e tyre, por sikur 10 000 lekë nga kjo shumë në muaj ata të kursenin, rezulton që e përmbys atë diferencë dhe ju jep mundësinë prindërve të ish-bashkëshortes, e cila e ka marrë këtë hua para se ai të lidhte martesë me të dhe është shlyer përpara se ai të lidhte martesë me të.

**32.6** Komisioni, pasi administroi parashtrimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, konstatoi se për shkak të një gabimi në formulën e eksportuar nga analiza financiare në *excel* shuma e rezultatit negativ prej 5,069,800.42 lekë është përlllogaritur gabim, duke e ngarkuar subjektin me barrë prove për një vlerë më të lartë sesa vlera reale. Kjo shumë është korrigjuar duke u rregulluar formulat në *excel*, nga ku rezulton se rezultati negativ është 959,709.84 lekë dhe kjo duhet të ishte shuma me të cilën duhet të ishte ngarkuar subjekti me barrë prove.

	Rezultati kumulativ 1995-2011
<b>Pasuri</b>	<b>1,200,000.00</b>
<i>Ndryshim i likuiditeteve</i>	<i>1,200,000.00</i>
<b>Të ardhura</b>	<b>7,398,580.00</b>
Të ardhura nga pensionet	7,398,580.00

Të ardhura nga A. Ç	0.00
<b>Shpenzime</b>	<b>7,158,289.84</b>
<i>Shpenzime jetike</i>	<i>3,700,789.84</i>
<i>Shpenzime për dhënien e huas 25,000 euro</i>	<i>3,457,500.00</i>
<b>Mundësia për të kursyer</b>	<b>-959,709.84</b>

Komisioni, bazuar dhe në shpjegimet e subjektit në lidhje me huan 25.000 euro konstaton se:

- i. huaja është marrë nga znj. E.Ll tek prindërit e saj në vitin 2011, në një kohë kur ajo nuk ka qenë ende e martuar me subjektin e rivlerësimit;
- ii. huaja, të paktën deri në momentin e dhënies së vendimit për ish-bashkëshorten e subjektit, vijon të jetë ende e pashlyer në shumën e origjinës prej 25.000 euro;
- iii. huaja është marrë në kushtet e një marrëdhënie të posaçme prind - fëmijë midis znj. E. Ll dhe prindërve të saj;
- iv. nga hetimi nuk rezultoi që kjo hua ose një pjesë e saj të jetë shlyer me të ardhurat e subjektit ose gjatë kohë që ai ka qenë i martuar me znj. Ll;
- v. prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit nuk janë subjekte deklarimi dhe për rrjedhojë nuk kishin detyrimin ligjor për të deklaruar të ardhurat e përfituara nga familja Ç.
- vi. familja Ç ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 40,000 lekë në muaj prindërve të ish-bashkëshortes;
- vii. shlyerja e huas në bankë në shumën 24.500 euro është bërë nëpërmjet një derdhjeje nga znj. A. Ç.
- viii. prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit nga analiza financiare rezultojnë me një bilanc negativ në vlerën 959,709.84 lekë për periudhën 1995-2011.

Komisioni, bazuar në konstatimet e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin që subjekti nuk ka një lidhje të drejtëpërdrejt me huan në shumën 25.000 euro, pasi ai në momentin e marrjes së kësaj huaje nuk ka qenë palë, si dhe nuk rezulton të ketë qenë i martuar me znj. Ll si dhe aktualisht ai nuk ka asnjë lidhje me këtë hua, pasi kjo hua është një hua e marrë nga ish-bashkëshortja e tij tek prindërit e saj, vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të prindërve të ish-bashkëshortes së tij.

Komisioni vlerëson se për sa kohë prindërit e ish-bashkëshortes nuk kanë qenë subjekte deklarimi, ata nuk kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar të ardhurat dhe shpenzimet, duke mos lindur nevoja për formalizimin e dhënies së shumës 40,000 lekë/muaj nga familja Ç tek ta, pasi kemi të bëjmë me një marrëdhënie të posaçme prind - fëmijë. Nga hetimi ka rezultuar e provuar se familja Ç kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 40,000 lekë/muaj prindërve të ish-bashkëshortes së subjektit si dhe për dhënien e dhuratës në shumën 2,000,000 lekë ish-bashkëshortes së subjektit dhe të kryerjes së pagesës mujore të znj. Ll.

Në frymën e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka për detyrë të hetojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë objekt huaje. Në këtë kuadër, Komisioni ka hetuar për (i) huamarrësin, që është ish-bashkëshortja e subjektit; (ii) e cila ka marrë hua nga prindërit e saj, të cilët si persona të tjerë të lidhur duhet të provojnë burimin e të ardhurave; (iii) që pretendojnë se i kanë përfituar nga ndihma e vajzës tjetër të tyre, znj. Ç.

Përveç arsytimit më sipër, Komisioni, pasi u sigurua për mundësitë financiare të znj. Ç, duhet të vlerësojë mënyrën/dokumentacionin e dhënies së ndihmës mujore, si dhe shpenzimin e të ardhurave nga z. dhe znj. Ll. Duke qenë se kemi të bëjmë me marrëdhënie prind-fëmijë si dhe mes personave pa detyrim për deklarim, është i pranueshëm dhe i besueshëm fakti se znj. A.Ç ka ndihmuar prindërit e saj rregullisht, që nga viti 1995, me shumën 40 000 lekë. Kjo nuk do të binte ndesh as me traditën dhe logjikën shqiptare për ndihmën e prindërve pensionistë nga fëmijët që i kanë mundësitë ekonomike.

E vetmja pikëpyetje që ngrihet në këtë marrëdhënie është fakti se a duhet t'i kishin shpenzuar krejtësisht këto të ardhura zotërinjtë Ll për rritjen e nivelit të tyre të jetesës apo mund t'i përdornin edhe për kursime?

Në këtë pikë, Komisioni vlerëson se është jashtë tagrit të tij të kërkojë arsyet se përse nuk janë shpenzuar këto të ardhura, por janë kursyer. Nga ana tjetër, duket bindës edhe arsyetimi i subjektit, se sikur vetëm 10 000 lekë në muaj të kishin kursyer zotërinjtë Ll, do të kishin pasur mundësi huadhënie në shumën 25 000 euro. Në këtë arsyetim, të bind edhe fakti tjetër se, edhe pas dhënies së kësaj huaje në vitin 2011, zotërinjtë Ll kanë pasur mundësi dhe kanë kursyer edhe më tej për krijimin e depozitave në banka.

Në këto rrethana Komisioni vlerëson se prindërit e ish-bashkëshortes kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huasë 25.000 ish-bashkëshortes së tij.

Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro e ka pasur ish-bashkëshortja e subjektit, e cila është gjykuar nga një trup tjetër, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm. Pavarësisht kësaj, nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezultoi se prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit kanë pasur të ardhura financiare të mjaftueshme me burime të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas ish-bashkëshortes së subjekti në shumën 25,000 euro.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**34.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**34.1** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**34.2** Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

**34.3** Në lidhje me problematika e konstatuara/ çështjet e trajtuara me lart në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se: (i) pavarësisht mospërputhjes të konstatuar midis deklaratës noteriale të bashkëshortëve Ç me deklaratimet e ish-bashkëshortes së subjektit në DPV/2004 në vështrim të Aneksit D pika 5 të Kushtetutës mospërputhjet në deklarime nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore apo të sjellin pasoja për subjektet për sa kohë ato nuk janë përpjekur të fshehin apo të deklarojnë në mënyrë të pasaktë pasurinë; (ii) balanca negative e fondeve në vitin 2006 prej 95,792 lekësh dhe në vitin 2011 në shumën 10,604 lekësh, janë në një vlerë të papërfillshme për të sjellë si pasojë zbatimin e nenit 61/3 të ligjit 84/2016; (iii) pavarësisht faktit nëse prindërit e ish-bashkëshortes kanë pasur ose jo të ardhura për dhënien e huas në shumën 25.000 euro, nuk mund të shërbejnë si shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit për sa kohë kemi të bëjmë me një detyrim të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ish-bashkëshorten e tij, të lindur para martesës me të, si dhe aktualisht ky detyrim nuk i përket subjektit, por ish-bashkëshortes së tij, që është subjekt rivlerësimi më vite.

**34.5** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut të drejtësia.

**34.6** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**35.** Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016.

**35.1** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin<sup>62</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**35.2** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**35.3** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**36.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

37. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor**

**38.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

<sup>62</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, përditësuar e deklasifikuar me vendimin nr. \*\*, datë 1.3.2019, të KDZH-së.

dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**38.1** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ.

**38.2** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**38.3** Gjetjet në lidhje me tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

Nga ana e KLGJ-së, në lidhje me dokumentin nr.1 “Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.3.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurit A. M, i akuzuar për veprën penale të “Marrëdhënieve seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal” Komisioni administroi dosjen gjyqësore<sup>63</sup> që i përket këtij vendimi pasi nga KLGJ-ja ishte konstatuar se: *“Në dukje konkluzion i gjykatës ishte në kontradiktë me përmbajtjen e dispozitës materiale penale dhe aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\*, datë 01.08.2013, por në kushtet kur nuk ka të dhëna mbi vlerësimin ligjor të bërë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e prokurorit dhe të dosjes gjyqësore nuk mund të jepet një konkluzion më i plotë në lidhje me vlerësimin ligjor të këtij vendimi.”*

Nga analizimi i dosjes gjyqësore konstatohet se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykatat më të Larta. Në lidhje me dy dokumentat e tjerë nuk janë konstatuar problematika.

**38.4** Gjetjet në lidhje me 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short

**38.5.1** Nga ana e KLGJ-së në lidhje me 5 dosjet e përzgjedhura me shortë në dosjen nr.1 “Çështja penale nr. \*\* regjistri themeltar, datë 26.10.2011 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurve M.K dhe A.A (H), të akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2013” është konstatuar se:

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 26.10.2011. Nuk ka të dhëna për shortimin e saj dhe për mënyrën si i është caktuar gjyqtarit Gerd Hoxha.

Në lidhje me këtë konstatim Komisioni kërkoi informacion me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 12.11.2019 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresë nr. \*\*\*, datë 20.11.2019 ka vënë në dispozicion:

- listën e shortit të datës 27.10.2011 ku në faqen e dytë me numër rendor \* figuron e hedhur në short çështja penale me të pandehur A.A etj., tek subjekti.
- gjurmimin e përdoruesit për dosjen penale nr. \*\*\* Regj.Them., datë regj., 26.10.2011, që i korrespondon çështjes penale të lartpërmendur.

Gjithashtu KLGJ-ja ka konstatuar dhe:

- i. veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, kryesisht ato që kanë të bëjnë me njoftimet e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve nuk janë dokumentuar rregullisht. Janë caktuar 47 seanca gjyqësore, nga cilat 9 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 38 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e të pandehurit dhe mbrojtësit në 12 seanca, mungesa e dëshmitarëve dhe ekspertëve në 11 seanca, mungesa e prokurorit në 11 seanca, si dhe mungesa e gjyqtarit në 4 seanca;
- ii. nuk janë mbikëqyrur rregullisht aktet e njoftimit, duke sjellë shtyrjen e seancave. Në dosje nuk ka akte njoftimi për palët;

<sup>63</sup> Shih shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- iii. seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim;
- iv. dokumentacioni në dosje nuk është i rregullt. Në dosje nuk ndodhet fashikulli i prokurorit, disponimi i gjykatës në lidhje me kërkesën e prokurorit për përjashtimin e gjyqtarit, (nëse kërkesa e bërë nga prokurori në seancë gjyqësore është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor) si dhe aktet e njoftimit të palëve;
- v. në procesverbalin gjyqësor evidentohet tërheqja e vëmendjes prokurorit në lidhje me presionin ndaj dëshmitares gjatë dhënjes së dëshmisë para gjykatës, por nuk ka elemente që mund të konsiderohen për shkelje të etikës dhe prokurori ka pretenduar për elemente që lidhen me paanësinë e tij dhe ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, por nuk ka kërkesë me shkrim të paraqitur dhe nuk ka vendim gjykate në lidhje me këtë;
- vi. në vendim ka pasaktësi në lidhje me individualizimin e dënimit, pasi flitet vetëm për të pandehurën M. K dhe jo edhe për A. A;
- vii. dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i arsyetuar janë depozituar jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale;
- viii. gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 vjet e 2 muaj. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit 9 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit;
- ix. subjekti i është referuar nenit 342<sup>64</sup> të K.Pr.Penale për shtyrjen e shpalljes së vendimit. Kjo referencë është e gabuar, pasi neni 342 bën fjalë për gjykimin e pandërprerë ndërkohë bazuar në nenin 379<sup>65</sup> të K.Pr.Penale i cili bën fjalë për menjëhershmerinë e marrjes së vendimit subjekti duhet të merrte vendim menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor dhe jo ta shtynte shpalljen e vendimit me 9 ditë. Në dosje nuk gjendet ndonjë dokument që të vërtetojë se subjekti ishte në pamundësi absolute dhe nuk gjendet urdhri i motivuar i kryetarit për shtyrjen e marrjes së vendimit.

**38.5.2.** Në lidhje me këtë dosje, vëzhguesi ndërkombëtar, në datën 11.11.2019 ka paraqitur mendimin nr. \*\*\* prot., sipas së cilit mendimi i vëzhguesit ndërkombëtar është që, për sa i përket çështjes nr. \* të shortuar, ndodhemi përpara ekzistencës së "gabimeve thelbësore dhe serioze" të kryera nga subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha, siç përcaktohet në pikën 45 të vlerësimit profesional, siç përcaktohet nga pika 54 e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017 i datës 18 janar 2017, i cili duhet të çojë Komisionin të konkludojë në lidhje mosekzistencën e kriterëve të parashikuara nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 interpretuar së bashku me nenin E, pika 5 e Aneksit. Gjithashtu, nga përmbajtja e raportit të vlerësimit profesional të dorëzuar nga KLGJ-ja, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se ka dyshime mbi mënyrën se si dosja nr. I e çështjeve të shortuara i është caktuar subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha dhe, për këtë arsye, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duhet të kryejë hetime të mëtejshme mbi këtë çështje.

<sup>64</sup> 1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.

2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.

3. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor shpallen nga kryetari në seancë. Shpallja zëvendëson njoftimin për ata që janë të pranishëm ose që duhet të quhen të pranishëm.

4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se dy nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para.

<sup>65</sup> 1. Vendimi merret menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor.

2. Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet përveçse në rast pamundësie absolute. Shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar.

Komisioni ka administruar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>66</sup> informacion në lidhje me procedurart e shortimit të çështjes penale të mësipërme bazuar në mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar. Gjykata ka informuar se dosja penale në ngarkim të shtetasve M. K dhe A.T (H) është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 26.10.2011 dhe po brenda kësaj date është regjistruar në regjistrin përkatës. Në datë 27.10.2011 i është nënshtruar shortit elektronik nëpërmjet sistemi *Ark-IT* dhe shorti ka caktuar gjyqtar subjektin. Evidentimi i shortit elektronik bëhet nëpërmjet listës së datës repsektive të prodhuar nga vetë sistemi.

Në përfundim Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me konstatimet e KLGJ-së dhe Mendimin e Vëzhguesit ndërkombëtar për sa i përket dosjes nr.1.

**38.5.3** Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se:

- Lidhur me konstatimet i) dhe ii)

...Nga këqyrja e dosjes gjyqësore rezulton se, veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, kryesisht ato që kanë të bëjnë me njoftimet e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve janë dokumentuar rregullisht. Nga të dhënat e administruara në dosjen gjyqësore nr. \*\* Rregj. Them., datë ardhje 26.10.2011, volumi \* i saj rezulton se, njoftimet e urdhëruara e nënshkruara nga ana e tij janë të renditura nga fq. \*\* deri në fq. 116... Këto njoftime janë kryer duke respektuar parashikimet e neneve 132-142 të KPP: a) në fillim janë kryer me anë të fletëthirrjes, të cilat dorëzohen në destinacion nga shërbimi postar apo/dhe ftuesi i Gjykatës; b) pasi nga fletëthirrja ka rezultuar se, personi nuk njihet apo ka pasur dyshime mbi mënyrën e njoftimit, nga ana e tij është urdhëruar kërkimi, gjetja dhe njoftimi i dëshmitarëve, ekspertëve apo subjekteve të tjerë proceduriale, duke paralajmëruar policinë gjyqësore, për detyrimin ligjor që kanë për kryerjen e këtyre njoftimeve dhe kthimin e përgjigjes përpara datës së caktuar për t'u zhvilluar seanca gjyqësore. Madje, ky njoftim i është drejtuar edhe Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, si organi epror në qarkun e Tiranës për policinë gjyqësore, që merret me zbatimin e urdhrave të Gjykatës në rastet e njoftimit të të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve dhe çdo pale në një process penal, përveç prokurorit dhe avokatit. Këta të fundit janë lajmëruar me anë të njoftimit<sup>67</sup> dhe fletëthirrjes. Në bazë të neneve 132 -143 të K.Pr.Penale këto janë kompetencat e gjyqtarit dhe nuk ka të tjera mundësi apo kompetenca sesi mund të mbikëqyrë kryerjen e njoftimeve...

- Lidhur me konstatimin iii)

Në nenin 115 të KPP<sup>68</sup> parashikohen format, mjetet dhe mënyrat e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme që ka qenë në fuqi në vitet 2011 – 2013 por edhe dispozitës që është sot në fuqi rezulton se, regjistrimi audio nuk është i detyrueshëm por fakultativ, në bazë të mundësive objektive që ka Gjykata, ku ushtron detyrën gjyqtari i caktuar si dhe natyrës dhe kompleksitetit të proceseve që zhvillohen në këtë Gjykatë. Në bazë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2021<sup>69</sup> të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se regjistrimi audio i seancave gjyqësore në Dhomën Penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar mbi bazën e urdhrit nr. \*\*\* prot, datë 15.5.2013 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlen të theksohet se, edhe në këtë periudhë

<sup>66</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2018 dhe \*\*\* prot./ datë 20.11.2019.

<sup>67</sup> Neni 134 i KPP partashikon se: "Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në format e parashikuara nga neni 133..."

<sup>68</sup> Neni 115 i KPP, i ndryshuar me ligjin nr.35/2017 parashikon se: "1.Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv..." Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore. 2. ...."

<sup>69</sup> Shkresa nr.\*\*prot, dt.07.05.2021 e Gjykatës së Rrethit Gjyësor Tiranë së bashku me kopje të urdhrave për regjistrimin audio, kopje të urdhrave për miratimin e organikës në gjykatë, kthimin përgjigje me e-mail nga përgjegjësjja e IT-së së Gjykatës si dhe ngarkesën në punë më janë vënë në dispozicion pas kërkesës sime dt.05.05.2021 Këto dokumenta janë të listuara në Aneksin 3, në cilësinë e provës, bashkëlidhur përgjigjeve të Relacionit.

kanë qenë të disponueshme vetëm 7 salla për 15 gjyqtarë. Ndërkohë që, sipas urdhrorit nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2014 të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur aplikimi i sistemit audio, duke shfrytëzuar sallat e gjyqit në Dhomën Penale sipas një kalendari të caktuar, i cili duhet thënë se në shumë raste nuk përputhej me nevojat e proceseve që zhvilloheshin në një ditë në Dhomën Penale.

Sa më sipër, qartazi arrihet në përfundimin se, mosregjistrimi në audio i seancave gjyqësore të çështjes, ka ardhur si pasojë e mosekzistencës së një sistemi të tillë deri në datën 15.5.2013.

- Lidhur me konstatimin iv)

Dosja gjyqësore është e plotë dhe dokumentacioni i renditur në mënyrë të rregullt, kronologjikisht sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Në dy volume të kësaj dosjeje gjenden lehtësisht të gjitha aktet e parashikuara nga ligji.

- Lidhur me konstatimin v)

Nga materiali i ndodhur në volumet e dosjes nr.1 rezulton se, në të ndodhet i administruar një fashikull më vete, me nr.\*\*\*rregj.them., datë regjistrimi 22.6.2012, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: "Përfundim gjyqtari". Ky gjykim është zhvilluar në dy seanca: datë 4.7.2012 dhe datë 10.7.2012 dhe ka përfunduar me rrëzimin e kërkesës së prokurorit si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Në këtë vendim me nr. \*\*\* akti, datë 10.7.2012, gjyqtari ka arritur në përfundimin se:

*"Për më tepër qëndrimi i gjyqtarit ndaj debatit të zhvilluar midis prokurorit dhe dëshmitares nuk tregon njëanshmëri... Kryetari i seancës ka vepruar sipas ligjit, ka drejtuar me korrektësi seancën gjyqësore...nuk është konstatuar asnjë rast që të çojë në përfundimin se, ka patur njëanshmëri gjatë gjykimit..."<sup>70</sup>.*

- Lidhur me konstatimin vi)

Ai në vendim, vetëm në një rast, ka cituar dy herë të pandehurën M.K. dhe jo të pandehurën A.A. Nga vendimi rezulton i qartë se, ai ka analizuar në veçanti rrethanat që shërbejnë për individualizimin e dënimit për secilën nga të pandehurat [shih fq.9-10 të vendimit]. Nëse lexohet në tërësi përmbajtja e vendimit, arrihet lehtësisht të kuptohet se ai ka renditur në mënyrë të plotë rrethanat, mbi të cilat është bazuar për individualizimin e dënimit për secilën ndaj të pandehurve M.K. dhe A.A....

Në rigjykim nga Gjykata e Apelit, arsyetimi i tij është konsideruar i plotë, i qartë dhe bazuar në prova dhe në ligj dhe Gjykata e Apelit Tiranë e ka lënë në fuqi si një vendim të drejtë e të bazuar në ligjin material dhe atë procedural.<sup>71</sup>

- Lidhur me konstatimin se gjykimi ka zgjatur tej afatit

Vetëm 4 (katër) nga 38 seanca janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga puna si gjyqtar, nga të cilat:

- seanca e datës 13.12.2011 është shtyrë, për shkak se, duke qenë pjesë e grupit të punës për ngritjen dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, është përzgjedhur për të trajnuar punonjësit e drejtësisë dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, lidhur me dënimet alternative...Si moderatore e këtij takimi ishte përcaktuar znj. A.B, gjyqtare në Gjykatën e Krimeve të Rënda, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Për shkak të angazhimeve të

<sup>70</sup> Shih vendimin nr. \*\* akti, datë 10.7.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fq. \* e tij ose fq. \* e dosjes gjyqësore me objekt "Përfundim gjyqtari".

<sup>71</sup> Shih vendimin nr. \*\*, datë 3.3.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndodhur në dosjen gjyqësore të listuar me nr. \*, tek Aneksi \*.



saj të papritura, gjyqtarja i ka kërkuar nëpërmjet e-mailit të saj<sup>72</sup> që ta zëvendësojë, me qëllim evitimin e dështimit të këtij seminari trajnues mjaft të rëndësishëm.

- seanca e datës 20.2.2012 është shtyrë për shkak se, gjykimi i çështjes kundër të pandehurve A.J. etj., me 7 të pandehur ka zgjatur disa orë, tej kohës së parashikuar nga ai prej 1orë, për shkak të pyetjes së dëshmitarëve.
- seanca e datës 30.4.2012 është shtyrë për shkak se ka qenë i angazhuar në projektet e ndryshme, lidhur me reformimin e sistemit të drejtësisë në vend, kryesisht atij penitenciar dhe shërbimit të provës. Takimet për këtë qëllim zhvilloheshin ndonjëherë në mënyrë të paparashikuar.
- seanca e datës 30.4.2013 është shtyrë, pasi ish-KLD-ja kishte shpallur datën e konkursit për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila u krijua për herë të parë me ligjin nr. 49/2012.
- 12 seanca janë shtyrë për mungesë të të pandehurave dhe të mbrojtësve të tyre ose e barabartë me më shumë se 6 muaj periudhë kohore. Një nga parimet bazë të sanksionuara në KEDNJ, Kushtetutën e RSH-së dhe K.Pr.P, është e drejta e çdo personi për t'u njohur me akuzën në ngarkim të tij dhe për t'i dhënë mundësinë të dëgjohet përpara një gjykate, nën praninë e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij apo, të caktuar nga shteti dhe për të paraqitur edhe provat e tij<sup>73</sup>. Shkelja e këtyre rregullave është e patolerueshme dhe passjell rigjykimin e çështjes, e për pasojë, zvarritje në dhënien e drejtësisë, venitjen e efekteve të dhënies së drejtësisë dhe cenim e besimit dhe të imazhit të drejtësisë në sy të publikut. Për pasojë, ai është përpjekur dhe përpiket maksimalisht t'u garantojë palëve në proces respektimin e këtyre të drejtave, të cilat përbëjnë shtyllat e një procesi të rregullt ligjor, konform parashikimeve të KEDNJ-së, vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë referuar si GJEDNJ), të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të RSH (më poshtë referuar si GJK dhe GJL).

Megjithatë, kur ka konstatuar se mungesa e të pandehurave apo/dhe mbrojtësve të tyre është e pajustificuar, ka proceduar me vijim e gjykimit në mungesë dhe/apo caktimin e mbrojtësve kryesisht, për të garantuar ligjshmërinë dhe kushtetueshmërinë e procesit penal. Ky veprim është kryer nga ai në seancat e datës 12.12.2012 dhe datës 28.6.2013 kur është caktuar kryesisht av. N. P për shkak të mungesës së paarsyeshme të të pandehurës A.A. dhe mbrojtësit të saj A.GJ., si dhe në seancën e datës 10.9.2013, kur është caktuar kryesisht av. M. R, për shkak të mungesës së paarsyeshme të të pandehurës A.A. dhe mbrojtësit të saj A.GJ. Për shkak të caktimit rishtaz të këtyre mbrojtësve, gjithnjë duke synuar zbatimin me përpikmëri të parimeve të cituara më sipër, ka ndërprerë seancën gjyqësore, për të njoftuar mbrojtëset dhe për t'u dhënë mundësi atyre të njihen me materialet mjaft voluminoze të çështjes, me qëllim garantimin e një mbrojtje sa më efektive.

Afati 9-mujor i përcaktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit është orientues dhe jo detyrues. Sipas legjislacionit procedural penal shqiptar nuk ka pasur dhe nuk ka afate detyruese për përfundimin e një çështjeje penale themeli.

Parashikimi që bën neni 6 i KEDNJ-së se gjykimi duhet të bëhet *brenda një afati të arsyeshëm*, është një *standard subjektiv*. Por, GJEDNJ në disa vendime të saj ka përcaktuar disa kritere për të vlerësuar nëse është respektuar ky standart që janë a) *kompleksiteti i çështjes*; b) *mënyra e trajtimit të çështjes*; c) *aspektet e sjelljes së vetë atij që ankohet, të cilat mund të kenë ndikuar në ndonjë vonesë, si dhe rrethanat e veçanta që mund të kenë justifikuar zgjatjen e procedurave*<sup>74</sup>.

<sup>72</sup> E-mail nga znj. A. B datë 16.11.2011, bashkëlidhur përgjigjeve të relacionit si Aneksi 4.

<sup>73</sup> Shih neni 6, pg. 3 i KEDNJ-së; neni 31 i Kushtetutës së RSH, neni 6 i K.Pr.P "Sigurimi i mbrojtjes".

<sup>74</sup> Shih vendimet e GJEDNJ-së: Vendimi *Konnig kundër Gjermanisë* pg. 97-111; Vendimi *Eckle* pg.71-95; Vendimi *Pretto dhe të tjerë kundër Italisë* pg. 29-37; Vendimi *Guincho kundër Portugalisë* pg. 28-41; Vendimi *Deumeland kundër Gjermanisë* pg.75-90; Vendimi *Tomasi kundër Francës* pg.123-125; Vendimi *Allenet dhe Ribemont kundër Francës* pg.42-57.

Në rastin e dosjes nr.1...vetë palët, me sjelljen e tyre kanë ndikuar në shtyrjen e procesit: 12 seanca të pandehurat dhe mbrojtësit e tyre dhe 11 seanca prokurori, që në total kanë shtyrë gjykimin me afërsisht 12 muaj, të cilat duhet t'i zbriten afatit prej 26 muajsh të konstatuar nga raporti i KLGJ-së, ku është bazuar edhe vëzhguesi ndërkombëtar...

- Lidhur me konstatimin se shtyrja e shpalljes së vendimit është bërë pa arsye ligjore

Sipas përmbajtjes së procesverbalit gjyqësor datë 17.12.2013, rezulton se Gjykata deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe është tërhequr për vendim. Pasi konstatova se, vetëm konkluzionet e Av. A.GJ. për të pandehurën A.A. ishin 43 faqe dhe nuk mund të lexoheshin e jo më të analizoheshin brenda një afati të arsyeshëm për të dhënë një vendim të drejtë, si dhe duke patur parasysh se, kishte për të gjykuar edhe 11 çështje të tjera atë ditë, konstatoi se ishte në pamundësi absolute për të shpallur vendimin, sikundër parashikon edhe pika 2 e nenit 379 të K.Pr.P, për shkak të kompleksitetit të çështjes, volumit të saj dhe konkluzioneve të palëve. Këto shkaqe janë shënuar në procesverbal nga gjykata. Këto shkaqe njihen si raste të pamundësisë absolute edhe nga literatura juridike shqiptare.<sup>75</sup>

- Lidhur me konstatimin se vendimi i arsyetuar është dorëzuar me vonesë

Rezultoi se vendimi është shpallur në datën 26.12.2013 dhe afati i parashikuar në nenin 113 të K.Pr.P fillon nga e nesërmja, d.m.th. përfundonte më 1.1.2014, e cila ishte festë zyrtare e për pasojë ditë pushimi, së bashku me datën 2.1.2014. Kështu që, afati i dorëzimit do të duhet të ishte data 3.1.2014, ditë e premte. Ndërkohë që, ai e ka dorëzuar vendimin më 6.1.2014, ditë e hënë kur është paraqitur në punë pas pushimeve zyrtare.

Subjekti ka depozituar provat e mëposhtme:

- a. kërkesë për informacion datë 6.5.2021, drejtuar Gjykatës së Lartë;
- b. kthim përgjigjeje nr.\*\*\*prot., datë 6.7.2021 e Gjykatës së Lartë;
- c. volum 1 i dosjes gjyqësore nr. \*\*\*;

Në faqen 3 të këtij volumi me emërtim “Lista e Dokumenteve që përmban” është cilësuar fakti se dosja gjyqësore përmban dhe dosjen hetimore nr. \*\*\*, \*\*volume.

- d. volumi 2 i dosjes gjyqësore nr.\*\*\*;
- e. volumi 3 i dosjes gjyqësore nr. \*\*\*akti, datë 22.6.2012 “Përjashtim gjyqtari”;
- f. volumi 4 i dosjes gjyqësore nr. \*\*\*\* e Gjykatës së Lartë;
- g. volumi 5 i dosjes gjyqësore nr. \*\*\*, datë 31.1.2017 e Gjykatës së Apelit Tiranë;
- h. kërkesë datë 5.5.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- i. kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2021 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Në këtë kërkesë sqarohet se me urdhrin nr. \*\*\*, datë 15.5.2013 është urdhëruar fillimi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore, të cilat zhvillohen në sallat e gjykimeve, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 18.06.2014 është vendosur aplikimi i sistemit audio duke shfrytëzuar sallat e gjyqit në Dhomën Penale, sipas një kalendari të caktuar.

- j. urdhër i Kryetarit nr. \*\*\*\* prot., datë 15.5.2013;
- k. urdhër i Kryetarit nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2013;
- l. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2011 e Ministrisë së Drejtësisë;
- m. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2012 e Ministrisë së Drejtësisë;
- n. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2013 e Ministrisë së Drejtësisë ;
- o. informacion nga specialisti i IT-së së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ;
- p. tabelë e ngarkesë së gjyqtarit Gerd Hoxha për periudhën 1.1.2011-31.12.2013;
- q. lista e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari Gerd Hoxha për periudhën 01.01.2011-31.12.2013;
- r. e-mail datë 9.12.2011, drejtuar znj. J. G;

<sup>75</sup> Shih “Komentarin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” me autorë H.I, I.P, K.S e A.H, botuar në Tiranë në vitin 1996, fq.253.

- s. e-mail datë 20.11.2011, drejtuar znj. A. B;
- t. e-mail datë 20.10.2011, nga znj. J. G;
- u. email datë 17.10.2011, drejtuar z. A.M;
- v. tabelën e orareve të gjyqeve të zhvilluara më 20.2.2012 nga subjekti;
- w. kapaku i dosjes nr. \*\*\* akti, datë 2.11.2011;
- x. vendim për caktimin e seancës gjyqësore datë 11.11.2011;
- y. procesverbal i seancës gjyqësore datë 20.2.2012.

Në seancën e datës 1.6.2021 subjekti në përgjigje të pyetjes së vëzhguesit ndërkomëbëtar sqaroi se: *“Unë kam dhënë shpjegime personalisht duke theksuar kompleksitetin e kësaj çështjeje sepse ishte një çështje që kishte rrethana mjaft komplekse...kam vënë re se gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me këtë çështje, pasi verifikuam materialet e ndodhura në dosjen gjyqësore e cilësuar nga ana juaj si dosja 1, më rezultoi se kontrolli nuk ka qenë i plotë. Kontrolli i KLGJ-së, mbi të cilën është bazuar vëzhguesi ndërkombëtar, nuk ka qenë i plotë madje i kanë munguar akte thelbësore, të cilat po të ishin administruar, unë ua kam vënë në dispozicion Komisionit e ndryshojnë tërësisht përfundimin e arritur. Po marr tre nga gjashtë elementët që ka gjetur i nderuari vëzhguesi ndërkombëtar. Së pari flasim për njoftimet .. Nga kontrolli që unë bëra në Gjykatën e Lartë ku ndodhet dosja për gjykim, mbasi ju më kaluat barrën e provës, konstatova që janë 135 fletënjoftimi, nga të cilat nga faqja 1-35 janë përgjigje të shkresave të drejtuar nga ana ime shërbimit postar apo autoriteteve të policisë gjyqësore, për të bërë njoftimet dhe nga faqja 35 -118... Një çështje tjetër sa i përket kompleksitetit të çështjes, kishin të bënin me një infermiere dhe një kryeinfermiere, më falni farmacistë, të cilat akuzoheshin për shpërdorim detyre. Çështja ishte e tillë që u administrua në seancë gjyqësore, jo vetëm provat e marra gjatë hetimit, të cilët ishin dy fashikuj të cilët unë i kam listuar, por edhe akte të tjera të cilat u bë hetim i gjyqësor gjatë gjykimit, këtu dua të nënvizoj edhe një gjetje tjetër të pasaktë të kontrollit të KLGJ-së, i cili ka futur si të thuash në qorrsoak edhe vëzhguesin e huaj, kur thotë se në dosje nuk ndodhet asnjë volum i hetimit. Jo vetëm që janë volumet, por unë kam kërkuar nga prokuroria e çështjes, sepse u ndërrua prokurorja që të bënte një listim të saktë të të gjitha provave...Sa i përket vonesave të tjera që janë realizuar gjatë këtyre seancave unë ju bëj me dije se nga 38 seanca, vetëm 4 seanca janë shtyrë për mua....përsa i përket dhe procesit të transparencës dhe solemnitetit është theksuar aty se seacnat janë bërë pa regjistrim audio dhe jo në salla. Më lejoni t’ju shpjegoj se bazuar në dokumentat që unë kam vënë në dispozicion të Komisionit, më rezulton se regjistrimi audio i seancave gjyqësore në Gjykatën e Tiranës , në bazë të dokumentave që unë kam , ka filluar me urdhër të kryetarit të gjykatës rreth datave 15 apo 20 maj të viti 2013...*

**38.5.4** Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit si dhe provat e paraqitur prej tij vlerëson se ato janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në lidhje me dosjen 1 konstaton se subjekti ka arritur të provojë bindshëm të gjitha pasaktësitë e konstatuara nga ana e KLGJ-së. Nga provat e administruara, duke i krahasuar me ato që gjenden në dosjen e vlerësimit profesional nga ana e KLGJ-së konstatohen se kjo e fundit nuk është e plotë, pasi nuk ka të përfshirë të gjithë volumet të cilat janë vënë në dispozicion nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit si dhe me dorëzimin me vonesë të vendimit Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit është provuar që këto vonesa kanë ardhura si pasojë e ngarkesës së madhe të tij në punë, kompleksitetit të çështjes, shtyrjes së seancave nga palët në proces si dhe shtyrjes të disa seancave për shkaqe që lidhen me impenjime të tjera të tij, për të cilat subjekti duhej të ishte treguar më i kujdesshëm për të shmangur përplasjen e datave. Nga vëzhgimi i dosjes gjyqësore rezulton se subjekti ka marrë të gjitha masat për njoftimin e palëve.

Pavarësisht vonesave të krijuara në lidhje me kohën e gjykimit, si dhe të zbardhjes së vendimit, Komisioni vlerëson se ato nuk mund të konsiderohen si shkaqe për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk janë shkaktuar për mungesë të organizimit të punës nga ana e subjektit. Në përfundim Komisioni vlerëson se në lidhje me dosjen nr. 1 nuk gjenden *“gabime thelbësore dhe serioze”*, siç përcaktohet nga pika 54 e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18.1.2017.

## **39. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

**39.1** Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se subjekti ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 15.07.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë që kryen dhe aktualisht.

Ai është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.12.2015 deri më 12.12.2018.

**39.2** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për subjektin janë paraqitur 7 ankesa (5 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

5 ankesa (3 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar ndër të cilat 4 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, dhe 1 ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur.

2 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për shkelje etike është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara;
- 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për zvarritje dhe mosrespektim formal ligji është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara.

**39.3** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

## **V. ANALIZA E GJETJEVE**

**40.** Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

### **40.1 Aftësitë profesionale**

a) Njohuritë ligjore

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Ai e analizon normën penale në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj. Ai ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve penale. Në arsyetimin e vendimeve përgjithësisht nuk merr në analizë kryesisht juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore. 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë njohuri të tij në të drejtën materiale penale dhe procedurale penale.

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislationit procedural penal. Ai bën pjesë të arsyetimit të vendimit çështjet procedurale lidhur me gjykimin e shkurtuar, por përgjithësisht nuk bën pjesë të arsyetimit të vendimit edhe çështje procedurale mbi juridiksionin gjyqësor, kompetencat lëndore e tokësore.

Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Përgjithësisht, vendimet e ndërmjetme jepen pas marrjes së mendimit të palëve, me disponim të qartë, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

### **40.2 Aftësitë organizative**

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016, subjekti ka përfunduar gjithsej 811 çështje gjyqësore, nga të cilat 558 çështje penale, 231 kërkesa penale dhe 22 kërkesa penale me të dëmtuar akuzues.

Sipas pikës 3 shkronja “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale). Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 300 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale) për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit konstatohet se ngarkesa e tij sasimore ka qenë mbi standardin minimal sasior.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short konstatohet se 1 çështje është gjykuar jashtë afatit standart të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht në intervalin kohor 2 vjet e 2 muaj (shih dosja 1) dhe 4 çështjet janë gjykuar brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti nuk i ka kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke i arsyetuar jashtë afatit ligjor. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 15 ditë nga shpallja (*shih* dosjen 1), duke vënë në vështirësi të pandehurën për të paraqitur ankim (në dosje është apelimi paraprak për zënie afati paraqitur nga e pandehura A. A më datë 8.1.2014), për 5 ditë nga shpallja (*shih* dosjen 2), për 4 ditë nga shpallja (*shih* dosjen 3), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 12 ditë nga shpallja (*shih* dosjen 5).

Edhe pse ka pasur ngarkesë sasiore të lartë konstatohen vonesa në arsyetimin e vendimeve, vonesa që në dy raste kanë ndikuar në ushtrimin efektiv të të drejtës së ankimit nga palët. Në lidhje me këtë konstatim subjekti edhe pse nuk i janë kërkuar shpjegime ka sqaruar se: Nga të dhënat e administruara nga dosjet gjyqësore, veçanërisht nga dosja nr.1, që iu përket të pandehurave M.K. dhe A.A. rezulton se, përfundimi i arritur nga KLGJ-ja është i pasaktë. Sikundër ka sqaruar dhe më sipër rezulton se Prokuroria dhe e pandehura M.K. kanë depozituar ankim të plotë, të pandikuar nga “*mosdorëzimi në kohë i vendimit gjyqësor*”. Vetëm e pandehura A.A. ka depozituar ankim të paplotë me pretendimin se vendimi nuk ishte zbardhur, pa kaluar ende afati 5-ditor i parashikuar nga neni 113 i K.Pr.P.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit përgjithësisht merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore, me përjashtim të dosjes nr. 5 ku afati është në tejkalim të parashikimit ligjor në nenin 333 të K.Pr.Penale.

Subjekti, jo në çdo rast e ka respektuar solemnitetin, për të zhvilluar gjykimin në sallë dhe duke i regjistruar audio seancat gjyqësore. Nga 5 dosjet e vëzhguara rezulton se vetëm në 2 raste gjykimi është zhvilluar në sallë, duke i regjistruar audio seancat gjyqësore.

Subjekti, zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet proceduriale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Distancat kohore midis seancave përgjithësisht respektojnë afatet ligjore, por ka raste kur shtyrja është në një afat kohor nga 15-33 ditë, në shkelje të afatit të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.Penale.

Përgjithësisht rezulton se në një rast nuk janë monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur shtyrjen e seancës. Në dosjen gjyqësore nuk ka akte njoftimi për palët, dëshmitarët dhe

ekspertët (shih dosja nr. 1). Në lidhje me këto konstatime që i përkasin dosjes 1 subjekti ka dhënë shpjegimet të cilat janë trajtuar me lart.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të përgjithshme të rregullta. Në një rast ku gjykimi ka vazhduar me procedurën e gjyqimit të zakonshëm nuk ndodhet fashikulli i prokurorit dhe sistemimi i akteve nuk e lehtëson përdorimin e saj (shih dosja 1). Procesverbali i seancës gjyqësore në të gjitha rastet është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera dhe i nënshkruar rregullisht prej sekretares gjyqësore dhe gjyqtarit, konform kërkesave të neneve 345 dhe 346 të K.Pr.Penale. Aktet 4 nga 5 dosjet e vëzhguara janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, duke u bërë lehtësisht të shfytëzueshme për palët dhe në fund është fashikulli i prokurorit. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht. Në një rast sistemimi i akteve nuk e lehtëson përdorimin e saj. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht.

### 40.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 15.7.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë që kryen dhe aktualisht. Ai është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.12.2015 deri më 12.12.2018.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit (*shih të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së*). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve me përjashtim të një rasti kur prokurori është shprehur në seancë gjyqësore se kërkon përjashtimin e gjyqtarit dhe është ndërprerë seanca për t’u shprehur një tjetër trup gjykues. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cënimin e standardit të gjykatës së paanshme.

### 40.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti komunikon me etikë me palët në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta..

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Ai ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 15.07.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë që kryen dhe aktualisht.

Subjekti është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore, si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.12.2015 deri më 12.12.2018.

Ai është Kryetar i Shoqatës “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë” që nga viti 2008. Gjithashtu, ai ka qenë pjesëmarrës si ekspert në 6 trajnime në programin e formimit vazhdues të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2014-2016 dhe si pjesëmarrës në 4 trajnime, si dhe ka marrë pjesë në aktivitete të organizuara jashtë Shkollës së Magjistraturës në 8 trajnime. Të dhënat e analizuara tregojnë se ai ka marrë pjesë 33 ditë në trajnime të formimit vazhdues për periudhën e rivlerësimit, si pjesëmarrës, ekspert dhe në trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës (në tri trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës nuk janë përcaktuar periudhat kohore në ditë). Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka qenë e ndryshme, duke i shërbyer detyrës së tij të gjyqtarit në dhomën penale të shkallës së parë, si dhe funksioneve të kryetarit të shoqatës. Subjekti është angazhuar gjithashtu, edhe në veprimtari akademike në institucionet e arsimit të lartë.

## **VI. GJETJET E VËZHGUESIT NDËRKOMBËTAR**

**41.** Gjatë procesit të hetimit administrativ, për subjektin e rivlerësimit, janë paraqitur dy gjetje nga vëzhguesi ndërkombëtar, të cilat janë pranuar nga Komisioni bazuar në pikën 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kuptim të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit material dhe procedural në vendimmarrjet kolegjiale si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe pasojave të ardhura në cenim të interesit publik.

### **41.1 Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>76</sup> në lidhje me vendimin e KLD-së për dhënien e lejes së posaçme magjistratit Gj.Gj.**

#### **Hyrje**

Vëzhguesi Ndërkombëtar i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), në lidhje me mbledhjen e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD), e zhvilluar më 11 tetor 2018, në lidhje me vlerësimin e qasjes së subjektit të rivlerësimit në vendimin ku KLD-ja (organ në të cilin bënte pjesë subjekti i rivlerësimit) i dha magjistratit Gj.Gj leje të posaçme me kohëzgjatje nga 1 nëntor 2018 deri në 31 tetor 2020, në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (që në vijim do të quhet: “Ligji për statusin”).

Objekti i analizës ka për qëllim të vlerësojë nëse qasja e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje – me sjelljen e tij aktive apo atë pasive – ka treguar një profesionalizëm që nuk do të cenonte

---

<sup>76</sup> Nr. \*\* prot., datë 13.1.2020.

besimin e publikut te gjyqësori. Në shtjellimin e argumenteve, vëzhguesi ndërkombëtar do të paraqesë një sërë gjetjesh, në bazë të pikës 10 të nenit 49 të *Ligjit të Vettingut*.

## **Përmbajtja e shkurtuar e gjetjes**

Në media ekzistojnë opinione, sipas të cilave vendimi i marrë nga KLD-ja, datë 11.10.2018, i cili i dha magjistratit Gj. Gj leje të posaçme me kohëzgjatje 1.11.2018 – 31.10.2020, ka qenë në shkelje të ligjeve materiale dhe procedurale, që ishin në fuqi në atë kohë. Sipas vëzhguesit është e nevojshme që këto pretendime të vlerësohen, pasi, nëse konfirmohen, besimi i publikut do të cenohet rëndë nga miratimi që u dha nga magjistratët e tjerë që morën pjesë në votim. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar nuk ka në fakt asnjë lidhje, që në kuadrin e KLD-së, vendimet kanë qenë “kolegjiale”, pasi ekzistenca e të metave të rënda në procesin e vendimmarrjes nuk do të shkarkonte, për efekt të rivlerësimit, secilin prej magjistratëve nga përgjegjësia e tij/saj, parë në këndvështrimin e të ashtuquajturit “besim i publikut”. Në vlerësim të përkufizimit ligjor mbi autoritetin e KLD-së<sup>77</sup> shprehur, si më poshtë:

*“[...] autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, arsimimin, vlerësimin moral dhe atë profesional, karrierën dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit”.*

KLD-ja duhej të vepronte sipas standardit më të lartë të zbatimit të ligjit, pasi veprimtaria e saj duhej të përbënte shembull të asaj çka do të thotë “zbatim ligji”. Kur një zbatim i tillë mungon në mënyrë të hapur dhe flagrante, do të ishte e paarsyeshme të mos i kërkohej llogari secilit nga magjistratët për miratimin e vendimeve të marra për qëllim të procesit të rivlerësimit. Një qasje e ndryshme dhe një interpretim ligjor i ndryshëm do të arrinte madje edhe të binte ndesh me Kushtetutën, pasi në pikën 1 të nenit 179/b të saj thuhet shprehimisht se një nga qëllimet e sistemit të rivlerësimit është “rikthimi i besimit të publikut” te gjyqësori.

Vëzhguesi ndërkombëtar parashtron si **gjetjen nr. 1** ekzistencën e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të dispozitës së përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që ka qenë në fuqi në atë kohë) për Këshillin e Lartë të Drejtësisë (i ndryshuar), parë në këndvështrimin e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e përjashton secilin prej magjistratëve nga shkaktimi i një vlerësimi negativ në bazë të pikës 5 të nenit 61 të *Ligjit të Vettingut* (sa herë që po këta magjistratë kanë marrë një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës apo që kanë marrë pjesë në votim, i cili ka kontribuar për nxjerrjen e një vendimi të tillë)....

Vëzhguesi ndërkombëtar do të dëshironte të paraqiste si **gjetjen nr. 2**, provat që përfshirja e kësaj pike në rendin e ditës u bë në shkelje flagrante të ligjit, pasi pika 6 e nenit 22 të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjeve, parashikonte: *“[...] Përjashtimisht, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.”*<sup>78</sup>

Nuk ka procesverbal dhe as ndonjë provë tjetër shkresore të besueshme që KLD-ja të ketë votuar ndonjëherë që të zbatojë dispozitën për të përfshirë kërkesën e magjistratit Gj. Gj në pikat e rendit të ditës së mbledhjes, e cila u zhvillua në datën 11.10.2018.

## **Konkluzion**

Duke pasur parasysh sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar i paraqet Komisionit këto gjetje:

- 1) ekzistenca e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh

<sup>77</sup>Neni 1 i ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar.

<sup>78</sup>Teksti i plotë i nenit 22 të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar.



nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat [nga përgjegjësia] që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të Ligjit të Vettingut, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kornizës ligjore përkatëse apo që kanë marrë pjesë në votim, i cili ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë;

- 2) shkelja flagrante në procesin që e çoi KLD-në më 11.10.2018 t’i jepte magjistratit Gj.Gj leje për periudhën 1.11.2018 – 31.10.2020 dhe posaçërisht, shkeljet flagrante dhe të hapura të dispozitave të pikës 6 të nenit 22, pikës 2 të nenit 24 dhe pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në atë kohë, si dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016, për shkaqet e shprehura në këtë dokument.
- 3) Shkeljet e dukshme që janë përshkruar në këtë gjetje, duhet të marrin vlerësim negativ nga Komisioni për sa i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha, i cili mori pjesë në vendimin me të cilin u miratua kërkesa për leje e magjistratit Gj.Gj. Një vendim i marrë nga autoriteti më i lartë, i ngarkuar me përfaqësimin e gjyqësorit në kohën e ngjarjes dhe që nga shumica dërrmuese e popullsisë konsiderohej se i takonte, ashtu si edhe institucione të tjera publike, të vendoste standardin e sundimit të ligjit në Shqipëri, për sa i përket ligjshmërisë.

Vëzhguesi e përmbyll gjetjen me arsyetimin se në rastin konkret, me mosveprimet e tij, subjekti Gerd Hoxha ka kontribuar në cenimin e besimit të publikut te institucionet e gjyqësorit dhe, për pasojë, një gjendje e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni, në kuadrin e pikës 5 të nenit 61 të *Ligjit të Vettingut*.

## **40.2 Gjetje vëzhguesit ndërkombëtar<sup>79</sup> në lidhje vendimin e KLD-së për rrëzimin e propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për gjyqtarin P. A**

### **Hyrje**

Vëzhguesi Ndërkombëtar i ka kërkuar informacione Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), në lidhje me mbledhjen e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD), e zhvilluar më 10 shkurt 2017, në lidhje me vlerësimin e qasjes së subjektit të rivlerësimit në vendimin ku KLD-ja (organ në të cilin bënte pjesë subjekti i rivlerësimit) vendosi të rrëzonte propozimin e bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit P. A, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>80</sup>.

Objekti i analizës ka për qëllim të vlerësojë nëse qasja e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje – me veprimet e tij aktive apo ato pasive – ka treguar një profesionalizëm, që nuk do të cenonte besimin e publikut te gjyqësori. Në shtjellimin e argumenteve, vëzhguesi ndërkombëtar do të paraqesë një sërë gjetjesh, në bazë të pikës 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

### **Përmbajtja e shkurtuar gjetjes**

Siç është shtjelluar tashmë në një gjetje tjetër, për këtë subjekt rivlerësimi më 13.1.2020 vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se ashtu si në **gjetjen nr. 1**, ekzistenca e një standardi ligjor në përputhje me interpretimin e orientuar nga Kushtetuta të dispozitës (që në atë kohë ka qenë dispozita përkatëse në fuqi) së nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001, “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar), në këndvështrimin e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e pengon që për secilin magjistrat të bëhet një vlerësim negativ, në bazë të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, sa herë që po këta magjistratë kanë mbështetur apo kanë dhënë një vendim të KLD-së, në shkelje flagrante të

<sup>79</sup> Nr. \*\*prot., datë 20.1.2020.

<sup>80</sup> Duhet të vihet në dukje që mbledhja e KLD-së u realizua një vit pas datës së dorëzimit të kërkesës së ministrit të Drejtësisë.

kuadrit ligjor të zbatueshëm apo që kanë marrë pjesë në votimin që ka kontribuar për marrjen e një vendimi të tillë.

Gjithashtu, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit, si **gjetje nr. 2**, që mungesa e një përgjegjësie penale për një veprim që përfshihet në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjisllacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës).

Për pasojë, si **gjetje nr. 3**, vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor, me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në germën “ç”<sup>81</sup> të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi, si dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>82</sup> në fund, për ekzistencën e përgjegjësisë penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal të Shqipërisë, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë.

Si rezultat, si **gjetje nr. 4**, vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore që përshkruhen në germën “ç” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008<sup>83</sup> janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal dhe se në veçanti germa “ç” e pikës 2 të nenit 32 të ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si p.sh., masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative, si ILDKPKI-ja).

Vëzhguesi ndërkombëtar ka bërë një analizë përmbledhëse për disa probleme të shënuara nga çështja e prokurorisë, vendimi nr. \*\*\* i të cilës ka lidhje me **gjetjen nr. 5**, e cila paraqitet këtu, pasi përmban informacione që do të mund të ishin vërtetuar nga KLD-ja, nëse kjo e fundit do të kishte vepruar siç duhej në kohën e ngjarjeve. Vëzhguesi ndërkombëtar ka konstatuar:

- mungesë hetimi për konflikt interesash;
- mungesë hetimi për automjetin që ka blerë në vitin 2009 i biri i P. A (në shumën 7,000 euro); i biri ka mbështetur deklarin e tij në ILDKPKI, duke thënë se e ka përdorur për të punuar si trupojë në Greqi gjatë periudhave të verës. Nuk rezulton që këto deklarime të mbështeten në ndonjë dokument ligjor;
- mungesë hetimi për shumën prej 50,000 dollarë, të marrë nga i biri i P.A në vitin 2008, nëpërmjet një transaksioni bankar;
- mungesë hetimi mbi borxhet / kreditë që ka marrë vetë P. A, si dhe legjitimitetin e tyre;
- mungesë hetimi për të ardhurat prej afro 47,000 dollarësh, të marra brenda tre muajsh (siç është deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2005 – por që më vonë, kur është intervistuar nga ILDKPKI-ja, kjo ka ndryshuar në një vit punësimi si avokat i lirë) nga dy firma (“Vëllezërit B” dhe “B. \*\*\*” sh.p.k.);
- Në përgjigjen e datës 1 korrik 2015 (nr. prot. \*\*\*) të U.F.T (një institucion financiar) drejtuar prokurorisë së Elbasanit, raportohet se “shtetasit për të cilët po bëni kërkime kanë kryer transfertat monetare, por, që t’ju përgjigjemi hollësisht, me qëllim që të respektohet privatësia e subjekteve, nga ana e prokurorisë duhet vendim sekuestrimi për hetimin e çështjes për veprat penale të kryera në vendin tonë, në bazë të nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale”. Duket se nuk u dërgua letër e dytë nga Prokuroria për hetim të mëtejshëm, pasi nuk rezulton në dosjen përkatëse.

<sup>81</sup>“[. . .] ç) refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive; [. . .] (germa “ç” e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008).

<sup>82</sup>[. . .] 3. Për shkeljet shumë të rënda që parashikohen në pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në germën “d” të pikës 2 të këtij neni [ . . . ] (*shkarkimi nga detyra — n.o.a.*)” (pika 3 e nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008).

<sup>83</sup>Shihni më sipër shënimin fundor nr. 2.

Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia: duket se P. A ka ankimuar vendimin e Prokurorisë së Elbasanit, me qëllim që të përftonte një vendim më të favorshëm, duke pretenduar se prokurori duhej të kishte nxjerrë përfundimin se “fakti nuk ekziston”, në bazë të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale<sup>84</sup>. Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor të Elbasanit ka çmuar se prokurori kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme dhe ka konkluduar në kuptimin e mungesës së elementeve objektive dhe atyre subjektive për kryerjen e krimit. Për pasojë, gjykata e rrethit ka deklaruar që vendimi për rrëzimin e procedimit penal nga prokurori ka qenë në përputhje me shkronjën “b” të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk u ankimua në Gjykatën e Apelit të Durrësit<sup>85</sup>.

### **Konkluzionet**

Duke pasur parasysh sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar i paraqet Komisionit këto **gjetje**:

- 1) ekzistencë e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5 të nenit 61 të *Ligjit të Vettingut*, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës apo kanë marrë pjesë në votim që ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë;
- 2) mungesa e përgjegjësisë penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe ato penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës);
- 3) ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008 që ka qenë atëherë në fuqi – dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në fund – për ekzistencën e përgjegjësisë penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal të Shqipërisë, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë;
- 4) elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore që përshkruhen në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008, janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal të Shqipërisë dhe se, në veçanti, shkronja “ç” e pikës 2 e nenit 32 e ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si për shembull, masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative – si ILDKPKI-ja).

Shkeljet e dukshme që janë përshkruar sa më sipër në gjetjet 2, 3 dhe 4, duhet të vlerësohen negativisht nga Komisioni në lidhje me subjektin e rivlerësimit Gerd Hoxha. Ai jo vetëm ka marrë pjesë në vendimin që ka rrëzuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, por ka argumentuar

<sup>84</sup> Vendim i Gjykatës së Rrethit Elbasan, nr. \*\*(\*\*\*)\* Vendim i datës 04.07.2016.

<sup>85</sup> Informacionet e mësipërme konfirmohen edhe nga P. A gjatë mbledhjes së KLD-së së datës 10 shkurt 2017, ku ka thënë:

*“Unë e kam bërë thjesht ankimin, duke qenë se e di që vendimet e prokurorisë në çdo kohë hapen (duke qene se jam vetë jurist). Vjen ndonjë prokuror tjetër, i vinte mendja dhe të thoshte "hajde ta fillojmë nga e para" dhe për këtë shkak e çova në gjykatë, për të marrë vendimiformë të prerë (po e doni shqip). Kjo është me e ndershme dhe po jua them kështu. Se e di që unë vendimin e prokurorisë dakord isha [...]”*. – Pjesë nga përkthimi i bërë nga ONM-ja në gjuhën angleze i procesverbalit të KLD-së së datës 10 shkurt 2017).

në mënyrë aktive me arsye të pabazuara ato përfundime, siç rezultojn nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë i datës 10 shkurt 2017.

Vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se, me sjelljen e tij, subjekti i rivlerësimit Gerd Hoxha ka kontribuar në mënyrë aktive për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe, si pasojë, një situatë e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni në përputhje me pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

#### **40.3 Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi se:**

**40.3.1** Shpjegime lidhur me gjetjen nr. 1 të vëzhguesit ndërkombëtar në lidhje me dhënien e lejes së posaçme magjistratit z. Gj. Gj

- Lidhur me çështjen e shtruar për zgjidhje nëse ka pasur veprimtari të kufizuar KLD-ja nga data 08.10.2016 e në vijim

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”) është bërë objekt shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese. Kështu, ndër të tjera është kërkuar shfuqizimi i nenit 160 të ligjit nr. 96/2016...Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, ndër të tjera, thekson se:

*“30. Duke i vlerësuar rregullimet ligjore të neneve 160/1 e 173/1 të ligjit në kontekstin e detyrimeve që imponon parimi i shtetit të së drejtës për respektimin e hierarkisë së akteve normative, Gjykata konstaton paraprakisht se neni 179 i Kushtetutës nuk përmban rregullim apo delegim të shprehur për ligjvënësin lidhur me përcaktimin e kompetencave që do të ushtrojë KLD-ja në periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGJ-së. Megjithatë, Gjykata vlerëson se ky konstatim nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se “anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, sipas ligjit” shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Për sa kohë vullneti i kushtetutëbërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, Gjykata vlerëson se KLD-ja ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës.”*

Lidhur me fuqinë juridike të arsyetimit të vendimive të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata mban parasysh vendimin nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Sipas këtij vendimi, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të njëjtë fuqi me Kushtetutën që ka epërsi mbi aktet e tjera normative të parashikuara nga neni 116 i Kushtetutës. Ndodhur në këto kushte, çmuj se në çështjen konkrete si KLD-ja deri në krijimin e KLGJ-së kanë qenë dhe janë të detyruara të mbajnë në konsideratë interpretimin pajtues të bërë nga Gjykata Kushtetuese.

- Lidhur me çështjen e shtruar për zgjidhje nëse ka qenë në fuqi neni 24 i Ligjit për Statusin në kohën kur është dhënë vendimi i KLD-së (datë 11.10.2018)

Lidhur me kohën e zbatimit të pjesës mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit, në nenin 169 të ligjit nr. 96/2016 nën titullin “Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve” parashikohet shprehimisht se: *“1. Pjesa mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit zbatohet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen..... 5. Pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019. .... Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera.”*

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, vetëm pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin jo më shpejt se 1 janar 2019.

Në pjesën II, kreu III bëjnë pjesë vetëm nenet nga 11 deri 22, ndërsa për nenet e tjera ku bën pjesë dhe neni 24 i ligjit nr. 96/2016, kanë qenë të zbatueshëm që me hyrjen në fuqi të këtij ligji, më 22.11.2016. Kjo për faktin pasi ligji nr. 96/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, më 7 nëntor 2016. Vetë ligji, në nenin 175 të tij, përcakton se “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Rezulton se ky afat 15-ditor është plotësuar në datën 22.11.2016.

Leja prindërore e dhënë magjistratit Gj. Gj me vendimin nr. \*\*, datë 11.10.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është konfirmuar dhe me vendimin nr. \*\*, datë 5.6.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke pranuar kërkesën e tij, për përjashtimin e tij tërësisht nga ushtrimi i veprimtarisë gjyqësore dhe si anëtar i Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, për periudhën 2-vjeçare të lejes prindërore.

Përpara se t’i akordohej leja prindërore magjistratit Gj. Gj, nga KLD, bazuar në nenin 24 të ligji nr. 96/2016 janë miratuar këto vendime: **i)** vendimi nr. \*\*, datë 22.9.2017 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi miratimin e lejes prindërore për gjyqtaren R.M”, ku është vendosur t’i akordohet leje prindërore gjyqtarës R.M, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri më 6.8.2020; **ii)** vendimi nr. \*, datë 9.2.2018 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për dhënie leje për arsye shëndetësore familjare gjyqtarës E. S”, ku është vendosur t’i akordohet leje gjyqtarës E. S, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një periudhë dyvjeçare, duke filluar nga data 1.4.2018; **iii)** vendimi nr. \*\*, datë 7.5.2018 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për dhënie leje për arsye shëndetësore familjare gjyqtarës E. G”, ku është vendosur t’i akordohet leje gjyqtarës E. G, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për një periudhë 12-mujore, deri në prill 2019, me të drejtë zgjatje të afatit të lejes deri në 2 vjet. Pra, aplikimi i nenit 24 të ligjit nr. 96/2016 që prej miratimit të tij është zbatuar në mënyrë korrekte nga KLD për të gjithë gjyqtarët pa bërë diferenca.

Kjo tregon se magjistrati Gj.Gj nuk është favorizuar nga KLD-ja dhe nuk kishte asnjë arsye pse të bëhej diskriminohet në raport me magjistratët e tjerë vetëm për faktin se ka qenë anëtar i KLD-së, pasi kjo do të binte në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës.

Në këtë mbledhje, pasi është komanduar Kryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, Presidenti i Republikës, në cilësinë e kryetarit të KLD-së, ka qenë dakord që të shqyrtohej në rendin e ditës kërkesa e magjistratit Gj. Gj, për leje prindërore dhe nuk ka pasur asnjë kontestim lidhur me rendin e ditës.

E njëjta praktikë është ndjekur disa herë nga KLD. Koncretisht me mbledhjen e datës 9.2.2018 kur është pezulluar nga detyra Kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës dhe është komanduar një Kryetar tjetër. Po në këtë mbledhje, e cila ka qenë e jashtëzakonshme është futur në rend dite nga Kryetari i KLD-së, shqyrtimi i kërkesë për leje për arsye shëndetësore të gjyqtarës E. S, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një periudhë trivjeçare.

Në rastin e magjistratit Gj.Gj, sikurse rezulton nga procesverbali i mbledhjes, Presidenti i Republikës ka qenë dakord, që të futet në rendin e ditës kërkesa për leje prindërore e magjistratit Gj.Gj dhe nuk ka pasur kontestime për këtë.

40.3.2 Shpjegime lidhur me gjetjen nr. \* të vëzhguesit ndërkombëtar në lidhje me vendimin e KLD-së për rrëzimin e propozimit të Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor për gjyqtarin P. A.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë u konstatua se:

- përmbajtja e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë është pothuajse kopje e njëjtë, pa asnjë ndryshim e informacionit/kallëzimit të paraqitur nga ILDKPKI-ja dhe se Ministrisë së

Drejtësisë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor administrativ shtesë në lidhje me rastin në fjalë;

- nuk rezultoi që ILDKPKI-ja të ketë marrë më parë masa disiplinore për shkeljet e konstatuara nga vetë ky organ por, ka depozituar kallëzimin penal dhe ka njoftuar Ministrinë së Drejtësisë për marrjen në konsideratë të këtyre shkeljeve;
- nga përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e datës 10.2.2017 ka rezultuar se, mbi bazën e kallëzimit të ILDKPKI-së, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2015 për veprat penale të *“Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”* dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal.
- me vendimin datë 18.1.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan *“Për pushimin e çështjes penale nr.\*\*\*, viti 2015”* është vendosur: *“Pushimi i çështjes penale nr.\*\*\*, viti 2015”*. Nga materialet e vëna në dispozicion nga KLD dhe nga përgjigjet e gjyqtarit z.A rezultoi se ky vendim nuk është ankimuar nga ILDKPKI-ja dhe ka marrë formë të prerë, çka do të thotë se kallëzuesi ILDKPKI është pajtuar me vendimin e pushimit të marrë nga Prokuroria më 18.1.2016.
- me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2016, mbi bazën e ankimit të subjektit P.A, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lënë në fuqi vendimin e datës 18.1.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan *“Për pushimin e çështjes penale nr.\*\*\*, viti 2015”*. Për pasojë, jemi përpara *“gjësë së gjykuar”*, pasi kemi një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk mund të vihet në diskutim nga asnjë organ tjetër shtetëror.

Nisur nga rrethanat e faktit të konstatuara rreth një vit e gjysmë pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarit P.A, për shkaqe procedurale dhe kushtetuese kam mbështetur votën time kundër kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarit A.

Me vendim të formës së prerë është arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë elementet objektive e subjektive të veprave penale të *“Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”*, *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal.

Në këto kushte, në bazë të nenit 143, 146/7 të Kushtetutës së RSH dhe neneve 31, 32, pika 1, germa “a”, pika 2 germa ç, neni 33 pika 1, pika 2, germa “d” e ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 *“Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nuk mund të pranohej kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore *“shkarkimin nga detyra e gjyqtarit”* ndaj z.P.A, pasi do të ndodheshim përpara shkeljeve procedurale që do të passillnin prishjen e vendimit të KLD-së nga Gjykata e Lartë, sikundër ka ndodhur edhe në raste të tjera (*p.sh: rasti i magjistratit A.Ç.*)

Prandaj, në respektim të parimit të sigurisë juridike çmoj se KLD-ja në rastin e procedimit disiplinor të magjistratit P.A nuk mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm, për sa i përket faktit nëse kishte deklaram të rremë të pasurisë apo fsheje të saj, si dhe nëse kishte burime të ligjshme për krijimin e saj, përderisa nga hetimi i Prokurorisë dhe i konfirmuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë rezultoi në pjesën arsyetuese se, magjistrati kishte burime të ligjshme dhe mungon si ana objektive (deklarami i rremë dhe fshehje e pasurisë) dhe ana subjektive (fajësia në formën e dashjes për deklaram të rremë dhe fshehje të pasurisë)...Me kënaqësi konstatoj se, gjatë diskutimit tim më 10.02.2017, kam ndarë të njëjtin qëndrim me vëzhguesin ndërkombëtar lidhur me faktin se: *“Mungesa e përgjegjësisë penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe*

*ato penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës) ”<sup>86</sup>.*

Theksoj se, trajtimi autonom i shkeljes penale që passjell vërtetimin e shkeljes disiplinore të kryer nga magjistrati, është i zbatueshëm vetëm në rastet e parashikuara nga neni 104 pika ç të ligjit nr. 96/2016 nën titullin “*Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale*”

**40.4** Komisioni, lidhur me këto dy gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi analizoi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, kushtet dhe rrethanat, veprimet e tij, si dhe pasojat e ardhura, çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat. Komisioni mban qëndrimin se subjekti në cilësinë e anëtarit të KLD-së nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, duke konkluduar se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në funksionin e tij si anëtar i KLD-së për këto dy raste brenda një fati 5-vjeçar në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duhet të jetë objekt i një hetimi të plotë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit dhe gjithë veprimtarisë së ushtruar prej tij në funksion të këtij statusi për të arritur në një konkluzion në lidhje me këto aspekte të punës së këtij magjistrati.

### **Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit**

**41.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 21 denoncime të paraqitura në Komision nga të cilat 9 denoncime janë paraqitur në mënyrë të përsëritur nga të njëjtët denoncues.

**41.1** Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, rezulton se në të gjitha denoncimet nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

**41.2** Ndërkohë, në lidhje me 1 denoncim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

Zj. M.B në denoncimin e saj pretendon se nuk është thirrur në seancën e datës 23.9.2020 pavarësisht se ka qenë prezent si dhe subjekti nuk ka qenë farë në Gjykatë në orën 13:30, orë në të cilën ishte caktuar seanca gjyqësore. Ajo pretendon se seanca nuk është zhvilluar në sallë dhe mungon audio e seancës së datës 23.9.2020.

**41.3** Subjekti në lidhje me këtë denoncim ka shpjeguar se:

Seanca e radhës e datës 23.9.2020, ora 13:30 ka filluar në orar. Sekretarja gjyqësore znj.S.Xh, në bazë të protokollit të caktuar në Gjykatë nga Këshilli i Gjykatës, ka lajmëruar me anë të telefonit të zyrës, punonjësin e Gjykatës që ndodhet në katin e parë dhe që ka për detyrë, mes të tjerave edhe thirrjen e palëve që kanë proces gjyqësor, identifikimin dhe kontrollin e tyre fizik, para se të hyjnë në ambientet e Gjykatës, ku zhvillohen gjykimet.

Sipas sekretares gjyqësore i është bërë me dije, se punonjësi në fjalë ka thirrur disa herë emrin e znj. M.B por, nuk është paraqitur askush. Për t’i dhënë mundësi znj. B apo prokurorit të paraqitej në seancë gjyqësore, sikundër ka praktikë gjatë gjithë këtyre viteve, kam pritur disa minuta, por sërish nuk është paraqitur askush. Në bazë të nenit 291 të K.Pr.P, gjykimi në të cilin ishte palë znj. M.B mund të zhvillohet edhe pa praninë e palëve, duke u bazuar në dokumentacionin e dosjes së prokurorit dhe/ose të sjellë nga palët.

Për shkak se, në këtë moment nuk ishte e pranishme asnjë nga palët (në përputhje me praktikën e ndjekur nga trupi gjyqësor i Dhomës Penale, e bazuar edhe në urdhrat e kryetarëve të Gjykatës ndër vite, për zhvillimin e seancave gjyqësore në salla, ku ka regjistrim audio, për t’u dhënë mundësi kolegëve të tjerë, të shfrytëzonin sallat për gjykimet ku ka palë të pranishme fizikisht) në orën 13:38 ka filluar seancën gjyqësore në zyrë dhe jo në sallat e gjykimit në katin e 2-të të Gjykatës. Materialet e prokurorisë ishin paraqitur në gjykatë muaj më parë dhe ai ka pasur

<sup>86</sup> Shih fq. 60, pg.2 e relacionit të Komisionit.

kohën e mjaftueshme për t'i shqyrtuar. Në këto kushte, ka vijuar gjykimin, duke e përfunduar atë. Gjatë kësaj dite ka planifikuar dhe zhvilluar disa procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse, për pasojë, ka qenë i pranishëm në gjykatë deri rreth orës 13:55, kur është larguar.

Në orën 14:00, nëpërmjet telefonit njoftohet nga sekretarja gjyqësore se, disa minuta pasi ishte larguar nga ambientet e Gjykatës, në zyrë është paraqitur shtetasja M. B, e cila ka kërkuar të dinte për ecurinë e gjykimit. Sekretarja gjyqësore i është përgjigjur se, gjykimi kishte përfunduar në mungesë të saj për shkak se, ajo nuk u paraqit në seancë edhe pas thirrjeve të realizuara nga punonjësi i gjykatës. Sipas sekretares gjyqësore, në këtë moment znj. B ka patur një reagim aspak etik, fyes e kërcënues, në kufijtë e konsumimit të veprës penale, duke e akuzuar padrejtësisht sekretaren gjyqësore se ajo nuk kishte kryer detyrën e saj dhe nuk e kishte thirrur për t'u paraqitur në gjykim. Për shkak të sjelljes dhe presionit të paligjshëm që znj.M. B po ushtronte ndaj sekretares gjyqësore, kjo e fundit ka njoftuar shërbimin e sigurisë në Gjykatë. Pas njoftimit, në zyrën e tij janë paraqitur punonjësit e policisë së burgjeve, të cilët kryejnë edhe detyrat e sigurisë në Gjykatë. Për këtë ngjarje është përpiluar shkresa më 23.9.2020, ora 14:30, me lëndë: *“Informacion: Mbi incidentin (ngjarjen) e ndodhur në dt.23.09.2020 në Gjykatën Penale në zyrën e gjyqtarit Gerd Hoxha me qytetaren M.J.B”* dhe *“Raport shërbimit”*<sup>87</sup>, nga specialisti i Policisë, grupi i gjykatave dhe objekteve kryekomisar I. K, kryekomisar S.L, punonjëset e shërbimit, inspektore M.H dhe inspektore R.M.

Sipas shkresës së mësipërme rezulton se, gjuha e përdorur nga ana e znj. B ishte joetike, fyesë dhe kërcënuese.

Subjekti ka paraqitur provat e mëposhtme:

- dosjen e çështje gjyqësore nr. \*\*\* regjistri, datë 30.7.2020, me objekt: *“kundërshtim vendimi prokurorisë me kërkes M.B”*;
- kthim përgjigjeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2020;
- kthim përgjigjeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2020;
- informacion mbi incidentin e ndodhur në datën 23.9.2020 në Gjykatën Penale në zyrën e gjyqtarit Gerd Hoxha me qytetaren M.J.B;

**41.4** Komisioni pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit vlerëson se ato janë bindëse.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**42.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

**43.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet *“i aftë”* në aspektin profesional.

**44.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës *“c”* të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**45.** Në lidhje me dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni referuar vendimit nr. 2 /2017, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”*, çmon se këto gjetje nuk përbëjnë shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit, pasi nuk ndikojnë në aftësitë profesionale të tij, si dhe nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm subjektin për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat, por që në

---

<sup>87</sup> Shkresat në fjalë më janë vënë në dispozicion pas kërkesës sime datë 6.5.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë dhe janë listuar nga unë në Aneksin 7.2.



zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, këto dy gjetje duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

### **KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në Dhomë Këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe në pikat 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, transferimin e gjetjes nr.\* \*\* prot., datë 13.1.2020 të vëzhguesit ndërkombëtar dhe gjetjes nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020 të vëzhguesit ndërkombëtar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 3.6.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtar**  
**(kundër)**

**GENTA Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**

**Sekretare gjyqësore**  
**Etmonda Hoxha**